FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 90

Tiranë – E hënë, 24 qershor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 19.6.2019	Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e audituesit energjetik.....	6403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 19.6.2019	Për miratimin e Planit të Veprimit 2019–2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.....	6420
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 19.6.2019	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit.....	6463
Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 156, datë 21.6.2019	Për delegim të përkohshëm të kompetencave.....	6491

VENDIM
Nr. 407, datë 19.6.2019

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS, TË KATEGORIVE, KUSHTEVE, KËRKESAVE TË KUALIFIKIMIT DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR PERSONIN, TË CILIT I LËSHOHET CERTIFIKATA E AUDITUESIT ENERGJETIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Objekti dhe fusha e veprimit

Ky vendim ka për objekt dhe e shtrin fushën e veprimit në:

a) përcaktimin e procedurës, të kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimit e të eksperiencës profesionale të audituesit energjetik;

b) përcaktimin e kushteve, për personat fizikë, për t'u pajisur me certifikatën e audituesit energjetik për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe/ose industri.

1.2 Përkufizimi i termave

Të gjithë termat e përcaktuar dhe që rrjedhin nga:

- ligji nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", i ndryshuar;

- ligji nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa";

- ligji nr. 68/2012, "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe të burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji";

- ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", së bashku me ndryshimet e ardhshme, që ata mund të pësojnë, kanë dhe do të kenë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Certifikatë e audituesit energjetik", certifikata e lëshuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE), që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri;

b) "Diplomë", dokumenti zyrtar, i lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, që dëshmon përfundimin me sukses të një programi studimi;

c) "Testim", testimi që kryhet nga AEE-ja për certifikimin e audituesve të energjisë, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

ç) "Regjistër", Regjistri i Audituesve Energjetikë të Certifikuar, që mbahet dhe përditësohet nga AEE-ja;

d) "Kushte dhe kërkesa të certifikimit", kushtet, përmbushja paraprake dhe/ose në vazhdimësi e të cilave janë të detyrueshme nga mbajtësi i certifikatës.

II. KATEGORITË, KUSHTET, KËRKESAT E KUALIFIKIMIT DHE TË EKSPERIENCËS PROFESIONALE PËR T'U PAJISUR ME CERTIFIKATËN E AUDITUESIT ENERGJETIK

2.1 Kategoritë e audituesve energjetikë

Audituesit energjetikë ndahen në dy kategori:

a) auditues energjetikë të certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa;

b) auditues energjetikë të certifikuar për auditimin e energjisë në instalime industriale.

2.2 Kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale të kërkuar për t'u pajisur me certifikatën e audituesit energjetik dhe detyrat e audituesit energjetik.

2.1.1 Çdo person fizik, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e auditimit energjetik ka të drejtë të aplikojë pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, për t'u pajisur me certifikatën e audituesit energjetik.

2.2.2 Personat fizikë pajisen me "Certifikatën e audituesit energjetik" nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë, nëse kanë kaluar testimin e njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe/ose në instalime industriale, pranë kësaj agjencie.

2.2.3 Të drejtën për t'u paraqitur në testimin e audituesve energjetikë e kanë vetëm kandidatët që paraqesin pranë AEE-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën e nivelit "Master i shkencave" ose "Master profesional", në një nga fushat e arsimit të lartë, si më poshtë vijon:

i. Inxhinieri mekanike (profili "Energjetikë"; konstruksione makinash dhe mjete lëvizëse; profili "Prodhim dhe menaxhim industrial");

ii. Inxhinieri elektrike;

iii. Inxhinieri fizike;

iv. Inxhinieri elektronike;

v. Arkitekturë dhe urbanistikë;

vi. Inxhinieri ndërtimi (profili "Ndërtim dhe administrim");

vii. Inxhinieri mjedisi (profili "Energjetikë");

viii. Shkencat e fizikës dhe kimisë industriale;

ix. Inxhinieri ekonomike;

b) librezën e punës, që vërteton dy vjet eksperiencë pune dhe përfshin përdorimin e energjisë në operacione mirëmbajtjeje e planifikimi;

c) certifikatën e lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë publike dhe/ose jopublike, që vërteton ndjekjen e programit të studimit të formimit të vazhduar, në formën e kurseve në fushën e "Auditimit të energjisë", në përputhje me ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

ç) dokumentin e identifikimit.

2.3 Detyrat e audituesit energjetik

Detyrat kryesore të audituesit energjetik janë:

a) të vlerësojë dhe të analizojë se si po përdoret energjia në një ndërtesë apo instalim industrial;

b) të identifikojë mundësitë për ruajtjen/kursimin e energjisë;

c) të rekomandojë se ku mund të reduktohet ose të optimizohet konsumi i energjisë;

ç) të përgatisë certifikatën e performancës energjetike të ndërtesës dhe/ose instalimit industrial në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën e energjisë në ndërtesa;

d) çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

III. TESTIMI PËR AUDITUESIT ENERGJETIKË

3.1 Testimi për audituesit e energjisë

3.1.1 Për qëllime të certifikimit të audituesve energjetikë, AEE-ja organizon kryerjen e testimit.

3.1.2 AEE-ja njofton datën, kohën dhe vendin e kryerjes së testimit, nëpërmjet publikimit të njoftimit në gazetë dhe në website-in e AEE-së.

3.2 Aplikimi për testimin e audituesve energjetikë

3.2.1 Një person që plotëson kushtet e kualifikimit për t'u paraqitur në testimin e audituesve energjetikë, të përcaktuara në pikën 2.2, të këtij vendimi, dorëzon pranë sekretariatit teknik kërkesën e aplikimit, sipas formularit të përcaktuar në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe dokumentet shoqëruese.

3.2.2 Dokumentet shoqëruese, që dorëzohen pranë AEE-së, duhet të jenë:

a) origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit;

b) në gjuhën shqipe ose të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre, si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3.2.3 Sekretariati teknik regjistron menjëherë, në protokollin e aplikimeve, kërkesat e regjistruara dhe përgatit kartelën shoqëruese të aplikimit.

3.2.4 Çdo dokumentacion aplikimi apo plotësime të tij shqyrtohet brenda 5 (pesë) ditëve pune nëse përmban ose jo, të plotë e të saktë, gjithë dokumentacionin përkatës, sipas këtij vendimi.

3.2.5 AEE-ja publikon në *website*-in e saj një përmbledhje për aplikuesit, e cila përmban skemën dhe modalitetet që rregullojnë testimin dhe materialin referencë për një testim të tillë, të paktën tre muaj përpara datës aktuale të testimit.

3.3 Pranimi për testimin e audituesve energjetikë

3.3.1 Pas shqyrtimit të formularit të aplikimit dhe dokumenteve shoqëruese, nëse aplikanti plotëson kushtet për t'u paraqitur në testim, komisioni i testimit vendos pranimin e kërkesës dhe sekretariati teknik njofton aplikuesin, nëpërmjet sistemit informatik ose me shkrim, duke i lëshuar aplikantit një formular pranimi ku shënohet vendi, data dhe koha e testimit, të paktën pesëmbëdhjetë ditë para datës së testimit.

3.3.2 Pas shqyrtimit të formularit të aplikimit dhe dokumenteve shoqëruese, nëse aplikanti nuk plotëson kushtet për t'u paraqitur në testim, komisioni i testimit refuzon kërkesën dhe sekretariati teknik njofton me shkrim aplikuesin për shkaqet e refuzimit.

3.4 Kalimi i testit

3.4.1 Një kandidat do të deklarohet se ka kaluar testimin për auditues energjetik nëse ka siguruar më shumë se një minimum prej 50% të pikëve maksimale për secilin nga modulet I, II, III e IV, si më poshtë vijon:

a) Moduli I: Aspekte të përgjithshme të menaxhimit dhe auditimit të energjisë;

b) Moduli II: Eficienca e energjisë në shërbimet/pajisjet termike;

c) Moduli III: Eficienca e energjisë në shërbimet/pajisjet elektrike;

ç) Moduli IV: Auditimi i energjisë për sistemet e pajisjeve dhe të shërbimeve në ndërtesa dhe industri.

3.4.2 Përmbajtja e katër moduleve të testimit I, II, III e IV përcaktohet në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

3.5 Komisioni për testimin dhe certifikimin e audituesve energjetikë

3.5.1 Pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë ngrihet komisioni për testimin dhe certifikimin e audituesve energjetikë, me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

3.5.2 Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- tre anëtarë nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë;

- dy anëtarë nga ministria përgjegjëse për energjinë.

3.5.3 Komisioni, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, merr vendime për:

a) pranimin apo refuzimin e kërkesës së aplikantit për t'u pranuar në testim;

b) kalimin e testimit nga kandidatët, që i janë nënshtruar testimit;

c) lëshimin e certifikatës mbi bazën e rezultateve të testimit;

ç) shfuqizimin e certifikatës dhe masat administrative, mbështetur, kryesisht, në kushtet e përcaktuara në këtë vendim;

d) përgatitjen dhe miratimin e fondit të pyetjeve si dhe përzgjedhjen rastësore të pyetjeve për testimin.

3.5.4 Komisioni thirret në mbledhje nga kryetari i tij. Kryetar i komisionit është drejtori i Përgjithshëm i AEE-së.

3.5.5 Në mbledhjen e tij të parë, komisioni zgjedh nënkryetarin e tij.

3.5.6 Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga nënkryetari i komisionit.

3.5.7 Mbledhjet e komisionit janë të mbyllura dhe në to mbahet protokoll nga një përfaqësues i sekretariatit teknik të komisionit. Protokolli mbahet në një libër të veçantë protokolli, të sekretuar me numër faqesh dhe përmban të dhëna, të paktën, për pjesëmarrjen, diskutimet, votimin dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve.

3.6 Sekretariati teknik

3.6.1 Sekretariati teknik i komisionit organizohet dhe funksionon pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë. Organizimi i sekretariatit bëhet në bazë dhe zbatim të strukturës organizative. Veprimtaria e tij zhvillohet në përputhje me rregulloren e brendshme të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë dhe me këtë vendim.

3.6.2 Roli i sekretariatit teknik, për qëllime të certifikimit të audituesve energjetikë, është i njëjtë me atë të përcaktuar në vendimin që miraton kategoritë, kushtet dhe kërkesat e kualifikimit për menaxherin e energjisë.

IV. CERTIFIKIMI I AUDITUESVE ENERGJETIKË

4.1 Certifikata e audituesve energjetikë

4.1.1 Agjencia për Eficiencën e Energjisë i lëshon personit, që ka kaluar testimin për auditues energjetik, "Certifikatën e audituesit energjetik", sipas formatit të përcaktuar në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4.1.2 Agjencia për Eficiencën e Energjisë është përgjegjëse për hartimin, përditësimin dhe publikimin në faqen zyrtare elektronike të saj të Regjistrit të Audituesve Energjetikë të Certifikuar, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

4.1.3 Arkivi i dokumentacionit të aplikimeve dhe certifikatave të miratuara organizohet sipas përcaktimeve në ligjin për arkivat, bashkë ose veçmas nga arkivi i Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, në bazë të urdhrit të veçantë të titullarit.

4.1.4 Pas regjistrimit në regjistër, audituesit energjetik të certifikuar i lëshohet karta e identitetit të audituesit energjetik nga ministria përgjegjëse për energjinë, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

4.1.5 Në rastin e humbjes ose dëmtimit të "Certifikatës së audituesit energjetik" ose kartës së identitetit të audituesit energjetik, me kërkesën e tij, AEE-ja lëshon një dublikatë të certifikatës ose kartës së identitetit.

4.2 Vlefshmëria e certifikatës

4.2.1 Certifikata e audituesit energjetik është e vlefshme për 7 (shtatë) vjet, me të drejtë rinovimi.

4.2.2 Rinovimi i certifikatës kryhet nga AEE-ja vetëm nëse audituesi energjetik i certifikuar i paraqet pranë saj certifikatën e pjesëmarrjes në kurse afatshkurtra të rifreskimit e përditësimit të njohurive, të organizuara nga AEE-ja, në trajnime të ndryshme të së njëjtës tematikë, të organizuara nga institucione ndërkombëtare të njohura nga AEE-ja si dhe nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi të formimit të vazhduar në fushën e menaxhimit të energjisë, në përputhje me ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

4.3 Revokimi i certifikatës

4.3.1 Agjencia për Eficiencën e Energjisë revokon "Certifikatën e audituesit energjetik" në përputhje me parashikimet e pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 124/2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar.

4.3.2 Në rastin e revokimit të "Certifikatës së audituesit energjetik", emri i tij hiqet nga Regjistri i Audituesve Energjetikë të Certifikuar dhe personi nuk ka të drejtë të kryejë auditime energjetike.

V. ANKIMI

5.1 Për çdo vendim të komisionit, individët kanë të drejtën e ankimit te ministri përgjegjës për fushën e energjisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit apo publikimit.

5.2 Titullari i ministrisë, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:

a) lënien në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni;

b) kthimin për rishqyrtim në komision të vendimit të marrë;

c) anulimin e vendimit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA I
FORMULARI I APLIKIMIT PËR TESTIMIN E AUDITUESIT ENERGJETIK

1. Testi për të cilin aplikoni: ◯ Auditues Energjetik ◯
2. Kandidati: ◯ I sponsorizuar nga kompania ◯ I vetësponsorizuar
3. Emri i aplikuesit:_____
4. Emri i babait:_____
5. Adresa aktuale e aplikuesit: Rruga/Qyteti/ Kodi postar_____
6. Adresa e perherëshme e aplikuesit: Rruga/Qyteti/ Kodi postar __.._____
7. Kombësia:
8. Data e lindjes: Data/Muaji/Viti
9. Statuti I punësimit: I punësuar ◯ I vetëpunësuar ◯ I papunë ◯
10. Emri dhe adresa e kompanisë:_____
11. Detaje të kontaktit: Telefon zyre_____Celular_____e-mail_____..
12.Eksperienca e punës në total: Vite _____. Muaj_____..
13. Edukimi arsimor

Nr.	Emri i diplomës	Dega	Viti i diplomimit	Universiteti
1.*				
2.				
3.				
4.				

14. Përvoja e punës për përmbushjen e kritereve të kualifikimit

Nr.	Emri i punëdhënësit/ organizata	Pozicioni	Vitet nga/deri	Përshkrim i shkurtër i punës (deri 50 karaktere)
1.*				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				

***Deklaratë e kandidatit**: Deklaroj se i gjithë informacioni i dhënë në formularin e aplikimit është i vërtetë sipas njohurive të mia. Bie dakord me kushtin që, nëse ndonjë informacion apo ndonjë deklaratë është gjetur e pasaktë, pranimi im në provim do të anulohet. Unë gjithashtu do të informoj AEE për çdo ndryshim të adresës, numrit të telefonit dhe e-mailit tim.*

Vendi:_____

Data:_____ Firma_____

SHTOJCA II
FORMATI I CERTIFIKATËS SË TESTIMIT TË AUDITUESIT ENERGJETIK

AGJENCIA PËR EFICIENCËN E ENERGJISË

Numri i regjistrimit për testim:_____ Numri i serisë_____
Numri i certifikatës së regjistruar_____

CERTIFIKATË PËR AUDITUESIN ENERGJETIK

- **Auditues energjetik në ndërtesa**
- **Auditues energjetik në instalime industriale**

Fotografia

Vërtetohet se Z./Znj./Zj._____
Biri/Bija i/e _____që ka kaluar Testimin për Audituesin Energjetik, në datë_____, kualifikohet si Auditues Energjetik i Certifikuar.

Kjo certifikatë është e vlefshme për një periudhë 7-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të certifikatës dhe do të jetë subjekt i rinovimit, duke iu nënshtruar ndjekjes së kursit afatshkurtër të përditësimit të njohurive, një herë në çdo pesë vjet.

Emri i tij/saj është regjistruar në regjistrin e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë për audituesit energjetikë të certifikuar me numër serie_____.

Lëshuar në datë _____ nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë.

(Firma dhe vula)

Drejtori

Agjencia për Eficiencën e Energjisë

SHTOJCA III
FORMATI I REGJISTRIT TË CERTIFIKATAVE TË AUDITUESVE ENERGJETIKË

_____.__(DD/MM/20YY)			
A.	**Informacion mbi certifikatën**		
1.	Emri i audituesit energjetik		
2.	Emri i babait		**Fotografia**
3.	Numri i regjistrimit për testim		
4.	Numri i certifikatës së regjistruar		
5.	Data e hyrjes në regjistër		
6.	Data e lëshimit të certifikatës		
7.	Data e rinovimit të certifikatës	1.	
		2.	
		3.	

B.	**Të dhënat e komunikimit**	
1.	Adresa postare	
2.	Adresa e-mail	
3.	Numra të telefonit.	

C	**Përvoja e punës për përmbushjen e kritereve të kualifikimit**						
	Nga		Në		Përshkrim i shkurtër i eksperiencës së punës		
	muaji	***viti***	***muaji***	***viti***	***Emri dhe adresa e punëdhënësit***	***I vetëpunësuar***	***Përmbajtja e punës/eksperienca***
1.							
2.							
3.							
4.							

D	**Informacion personal**	
1.	Data e lindjes	DD/MM/YY
2.	Kombësia	
3.	Edukimi arsimor	

	Diploma/kualifikime	***Institucioni/universiteti***	***Viti***
1.	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____
1.	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____

E	Shënime

SHTOJCA IV
FORMATI I KARTËS SË IDENTITETIT TË AUDITUESIT ENERGJETIK TË CERTIFIKUAR

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Tiranë

AUDITUES ENERGJETIK I CERTIFIKUAR

Fotografia

Numri i regjistrimit për testim.:_____

Numri i certifikatës së regjistruar.:_____

Emri:_____

Biri/Bija e:_____.

Adresa:_____.

Firma e audituesit energjetik të certifikuar

(Pjesa e prapa kartës së identitetit)

Data e lëshimit:_____ E vlefshme deri në:_____

Autoriteti që e lëshon

Emri:_____.

Pozicioni:_____

Adresa zyrtare:_____..

_____.

Firma dhe vula:_____

SHTOJCA V
FORMULARI I APLIKIMIT PËR RINOVIMIN E CERTIFIKATËS SË AUDITUESIT ENERGJETIK

Datë:_____

Nga

Z/Znj./Zj._____..

Numri i regjistrimit.:_____.

Adresa postale_____

_____.

Për

Drejtori

Agjencia për Eficiencën e Energjisë

Adresa:_____.

Z./Zonja,_____.

Lënda: Rinovimi i certifikatës së audituesit energjetik

Kjo është për t'ju informuar se kam ndjekur kursin e trajnimit për periudhën afatshkurtër dhe bashkëlidhur gjeni certifikatën e pjesëmarrjes së lëshuar për këtë qëllim.

Për sa më sipër, aplikoj për rinovimin e certifikatës së audituesit energjetik.

Me respekt,

(Emri Mbiemri)

(Firma)

SHTOJCA VI
PËRMBAJTJA E MODULEVE PËR TESTIMIN E AUDITUESVE ENERGJETIKË

MODULI I
ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT DHE AUDITIMIT TË ENERGJISË

A. Energjia dhe skenarët e energjisë
1. Hyrje në format e energjisë
- Puna, energjia dhe fuqia.
- Bazat e prodhimit të energjisë elektrike.
- Bazat e energjisë termike.
- Njësitë e energjisë dhe konvertimet.
2. Llojet e energjisë dhe burimet energjetike
- Energjia primare dhe sekondare.
- Energjia e tregtueshme dhe energjia jo e tregtueshme.
- Energjia e rinovueshme dhe ajo fosile.
- Rezervat globale të energjisë dhe prodhimi i energjisë për qëllime tregtimi.
3. Konsumi fundor i energjisë
- Tarifat e energjisë në Shqipëri, Enti Rregullator dhe tarifat e rregulluara.
- Bilanci i prodhimit dhe konsumit të Energjisë në Shqipëri.
- Konsumi i energjisë sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë në Shqipëri.
- Nevojat energjetike të ekonomive në zhvillim dhe Shqipëria.
- Intensiteti i energjisë.
4. Politikat e integruara të energjisë
- Skenarët afatgjatë të energjisë për Shqipërisë, Strategjia e Energjisë.
- Siguria energjetike.
- Eficienca dhe kursimi i energjisë. Rëndësia e reduktimit të gazeve me efekt serrë (GHG).

B. Legjislacioni i energjisë dhe eficiencës së energjisë
1. Ligji nr. 43, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- Tregu i rregulluar dhe liberalizimi i sektorit të energjisë.
- Operatorët e tregut të energjisë.
- Ndarja e kompanive shtetërore të prodhimit/transmetimit/shpërndarjes.
- Enti rregullator i energjisë elektrike, roli dhe mbrojtja e konsumatorit.
- Politikëbërja dhe roli i ministrisë përgjegjëse të energjisë.
2. Ligji nr. 102, datë 23.9.2015 "Për sektorin e gazit natyror".
- Operatorët e tregut.
- ALBGAZ.
- Transmetimi dhe shpërndarja, projekti TAP.
3. Ligji nr. 124, datë 12.11.2015 "Për eficiencën e energjisë".
- Plani Kombëtar i Veprimit të eficiencës së energjisë, objektivat kombëtarë.
- Institucionet përgjegjëse për eficiencën, detyrat dhe funksionet.
- Audituesit dhe menaxherët e energjisë, roli dhe përgjegjësitë.
- Agjencia për Eficiencën e Energjisë, roli, detyrat dhe përgjegjësitë.
- Fondi për eficiencën e Energjisë, statusi dhe roli.
- Kompanitë e shërbimeve energjetike.
4. Ligji nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".
- Plani Kombëtar i Veprimit për nxitjen e burimeve të rinovueshme të energjisë, objektivat kombëtarë.
- Agjencia përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë.

- Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Tarifat nxitëse dhe kontratat për diferencë. Operatori i BRE-së.
- Aksesi dhe kostot për lidhjen me rrjetin e energjisë elektrike.
- Skemat e matjes neto të energjisë, garancia e origjinës.
- Biomasa dhe biokarburantet. Prodhuesit me përparësi.

5. Ligji nr. 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji".
- Produkti, etiketa, skeda informative dhe përgjegjësitë e furnizuesve.
- Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.
- Kundërvajtjet administrative dhe ekzekutimi i vendimit.

6. Ligji nr. 116, datë 10.11.2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave".
- Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes për Llogaritjen e Performancës.

së Energjisë në Ndërtesa (PEN).
- Kërkesat minimale (normat) të (PEN).
- Llogaritja e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të (PEN).
- Përdorimi i sistemeve alternative me eficiencë të lartë. Ndërtesat me performancë "afër zero energji".
- Certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesave. Të dhënat që duhet të përfshihen në "Certifikatën për performancën e energjisë".
- Audituesit energjetikë për certifikimin e performancës së energjisë.
- Mbikëqyrja e përmbushjes së kushteve të (PEN).
- Detyrimet e subjekteve që kanë në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesa, kundërvajtjet administrative.

C. Menaxhimi i energjisë dhe auditi

1. Përkufizimet dhe objektivat e menaxhhimit të energjisë.
2. Përkufizimet e auditimit të energjisë dhe nevojat për auditim energjetik.
3. Llojet e auditimeve energjetike dhe qasjet ligjore. Kostot e energjisë.
4. Fazat e auditimit. Performanca energjetike.
5. Përputhja e kërkesës për energji me përdorimin e saj.
6. Maksimizimi i eficiencës së sistemeve energjetike, optimizimi i kërkesave energjetike në hyrje, zëvendësimi i lëndëve djegëse.
7. Instrumentet dhe matjet për auditin e energjisë.
8. Specifikat ligjore për auditimin e energjisë.

Ç. Bilanci energjetik dhe i lëndëve djegëse.

1. Hyrjet statistikore të domosdoshme.
2. Pjesët përbërëse të bilancit energjetik dhe lëndëve djegëse. Principet bazë.
3. Klasifikimi i proceseve dhe bilanci i materialeve.
4. Bilanci energjetik aktiv dhe pasiv.
5. Sistemet energjetike dhe analizat energjetike.

D. Planet energjetike të sistemeve të konsumit

1. Mbështetja e niveleve të larta menaxhuese.
2. Përcaktimi i profilit energjetik dhe përcaktimi i skenarit bazë.
3. Planifikimi dhe politikat e energjisë dhe zbatim/monitorimi i tyre.
4. Vlerësimi i performancës energjetike të konsumatorit të madh, vlerësimi i rezultateve.
5. Mjetet e menaxhimit për zbatimin eficient të planeve.

DH. Menaxhimi financiar i energjisë

1. Nevoja për investim, vlerësimi dhe kriteret.
2. Teknikat e analizës financiare*, Cash Flow.*
3. Analiza e riskut.
4. Mundësitë e financimit.

5. Kontraktimi i eficiencës së energjisë dhe roli i ESCO-s.
6. Zhvillimi i një kontrate tipike ESCO.
7. Rast studimor – eficienca e energjisë në ndërtesa nëpërmjet ESCO.
8. Kontraktimi i eficiencës së energjisë në bashki nëpërmjet kontraktimit të performancës.

E. Menaxhimi i projekteve energjetike

1. Çfarë është një projekt në energji?
2. Cikli i zhvillimit të një projekti (PDC).
3. Teknikat e planifikimit të projekteve.
4. Plani i zbatimit për nivelet e larta drejtuese.
5. Planifikimi i buxhetit, zbatimi dhe monitorimi projekteve.
6. Matja dhe verifikimi.

Ë. Objektivat dhe monitorimi energjetik

1. Çfarë janë objektivat dhe monitorimi në sistemet e konsumit të energjisë.
2. Dizenjimi i objektivave dhe monitorimi tyre.
3. Elementet kyç të sistemit të objektivave dhe monitorimit.
4. Burimet e të dhënave dhe informacioneve.
5. Analiza e të dhënave dhe informacioneve.
6. Programet kompjuterike të miratuara. Shembull - *Energy Management Information System* (EMIS).

F. Energjia dhe ndryshimet klimatike

1. Energjia dhe mjedisi. Çështjet mjedisore globale, shiu acid dhe hollimi i shtresës së ozonit.
2. Ngrohja globale, ndryshimet klimatike dhe impakti i ndryshimeve klimatike.
3. Marrëveshjet ndërkombëtare UNFCCC (*United Nations Framework Convention on Climate Change*).
4. Marrëveshja e Parisit COP21. NDC për Shqipërinë.
5. NDC – Dokument teknik dhe ligji për miratimin në Konventë. Objektivi shqiptar i NDC.
6. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përpjekjet e Bashkimit Evropian për të luftuar ndryshimet klimatike.

G. Burimet e reja dhe të rinovueshme të energjisë

1. Konceptet e energjive të reja dhe të rinovueshme.
2. Energjia hidrike për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike.
3. Bazat e energjisë diellore.
4. Energjia diellore për qëllime të prodhimit të energjisë termike.
5. Energjia diellore për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike.
6. Energjia eolike për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike.
7. Energjia nga biomasa.
8. Energjia nga FUEL CELL.
9. Energjia nga mbetjet.
10. Energjia nga dallgët.
11. Energjia nga baticat.
12. Energjia gjeotermike.

MODULI II
EFICIENCA E ENERGJISË NË SHËRBIMET/PAJISJET TERMIKE

I. Lëndët djegëse dhe procesi i djegies

1.Vetitë kalorifike të lëngjeve djegëse të lëngshme
2. Vetitë kalorifike të qymyrit të gurit dhe biomasave drusore
3. Vetitë kalorifike të lëndëve djegëse të gazta
4. Vetitë kalorifike të biomasave nga mbetjet e ngurta urbane dhe në agrikulturë
5. Procesi i djegies
- djegia e naftës
- djegia e qymyrit
- djegia e gazit
- djegia e biomasës
- Kontrolli i djegies

II. Gjeneratoret e nxehtësisë

1. Sistemet e kaldajave, llojet dhe klasifikimet
2. Vlerësimi i performancës (rendimentit) të një kaldaje tipike
3. Trajtimi i ujit të kaldajave për qëllime të prodhimit të avullit të tejnxehur
4. Shkarkimi i gazeve të djegies së kaldajave
5. Përmirësimi i gatishmërisë së kaldajave
6. Ngrohësit (gjeneratorët) termikë të fluideve
7. Mundësitë e kursimit të energjisë në gjeneratorët e nxehtësisë (kaldaja)
8. Sistemet me avull
9. Vetitë e avullit
- Shpërndarja e avullit
- Përdorimi efikas i avullit
- Përzgjedhja, operimi dhe mirëmbajtja e valvulave të shkarkimit
- Mundësitë e kursimit të energjisë te gjeneratorët me avull

III. Izolimi termik

1. Qëllimi i izolimit, llojet dhe aplikimi
2. Llogaritja e trashësisë së izolimit
3. Trashësia ekonomike e izolimit
4. Formula të thjeshtëzuara për llogaritjen e humbjeve të nxehtësisë
5. Izolimi i ftohtë, materialet rezistente ndaj nxehtësisë
6. Vetitë termike të materialeve izoluese rezistente ndaj nxehtësisë, klasifikimi i tyre, llojet tipike dhe përdorimi në industri. Përzgjedhja e materialeve izoluese
7. Humbjet e nxehtësisë nga muret e kaldajës
8. Vetitë termike të materialeve të ndërtimit. Referenca në Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së PEN

IV. Kogjenerimi dhe kaldajat FCB (Fluidised Bed Combustion)

1. Kogjenerimi.
- Nevoja për kogjenerim, parimet e kogjenerimit dhe mundësitë teknike për aplikim
- Klasifikimi i sistemeve të kogjenrimit dhe faktorët që ndikojnë në kogjenerim
- Parametrat e rëndësishëm teknikë të kogjenerimit dhe faktorët kryesorë për përzgjedhjen e sistemit të kogjenerimit
- Parametrat tipik të performancës së kogjeneratorëve
- Avantazhet e sistemeve të kogjenerimit
- Eficenca e turbinave me avull
- Përcaktimi i eficiencës së kogjenerimit
- Trigjenerimi

2. Kaldajat FCB
- Mekanizmat e funksionimit dhe tipat e kaldajave FCB
- Aplikimi i boilerëve FCB me biomasë
- Mikroturbinat

V. Rekuperimi i nxehtësisë
1. Klasifikimi dhe aplikimiet
2. Avantazhet e rekuperimit të nxehtësisë
3. Zhvillimi i një sistemi të rekuperimit të nxehtësisë
4. Pajisjet e tregut të rekuperimit të nxehtësisë
5. Rikuperimi i nxehtësisë në sistemet e ventilimit në ndërtesa

VI. Këmbyesit e nxehtësisë
1. Bazat e transmetimit të nxehtësisë
2. Konceptet e këmbyesit
3. Llojet e këmbyesve (sipas Rrjedhës)
4. Llojet e këmbyesve (sipas ndërtimit të këmbyesit)
5. Llojet e këmbyesve (Sipas aplikimit)
6. Analizat e eficiencës së energjisë

VII. ANEKS Listat e protokollit për kontrollin e eficiencës së energjisë në pajisjet termike

MODULI III
EFICIENCA E ENERGJISË NË SHËRBIMET/PAJISJET QË KONSUMOJNË ENERGJI ELEKTRIKE

a) Sistemet elektrike
1. Njohja me sistemet e furnizimit të energjisë elektrike
2. Faturimi i energjisë elektrike
3. Menaxhimi i ngarkesës elektrike dhe kontrolli i kërkesës maksimale në pikë.
4. Përmirësimi i faktorit të fuqisë dhe përfitimet
5. Transformatorët
6. Humbjet në shpërndarje në sistemet industriale
7. Vlerësimi i humbjeve të transmetimit dhe shpërndarjes në sistemet energjetike
8. Përcaktimi i humbjeve teknike në sistemin e shpërndarjes
9. Menaxhimi i kërkesës (Demand Side Management)
10.Harmonikat
11. Analiza e sistemeve të energjisë elektrike

b) Motorrët elektrikë
1. Llojet e karakteristikat të motorëve
2. Eficienca e motorëve dhe përzgjedhja e tyre. Motorët eficientë
3. Faktorët që ndikojnë në eficiencën energjetike dhe minimizimi i humbjeve gjatë operimit
4. Efektet e riavolzhimit në eficiencën e energjisë
5. Kontrolli i shpejtësisë në motorët me induksion AC
6. Etiketimet e eficiencës së energjisë në motorët eficientë me induksion.

c) Sistemet e ajrit të kompresuar
1. Llojet e kompresorëve, performanca e kompresorëve
2. Kompenentët e sistemeve të ajrit të kompresuar dhe operimi me eficiencë i këtyre sistemeve. Vlerësimi i kapacitetit të kompresorit
3. Listat e protokollit per kontrollin e eficiencës së energjisë në sistemet e ajrit të kompresuar

d) HVAC dhe sistemet e ftohjes
1. Tipat e sistemeve të ftohjes.
2. Llojet e kompresorëve dhe aplikimet. Ftohësit tipikë dhe karakteristikat

- Diagramat psikometrike dhe sistemi i ajrit të kondicionuar
- Zgjedhja e një sistemi të përshtatshëm ftohjeje
- Vlerësimi i performancës së impianteve të ftohjes
- Faktorët që ndikojnë në performancë dhe eficiencë të impianteve të ftohjes
- Vlerësimi i performancës i njësive të ajrit të kondicionuar të llojeve të ndryshme
- Sistemimet e ruajtjes së ftohjes

3. Pompat e nxehtësisë dhe aplikimet
4. Sistemet e ventilimit
5. Sistemet e ngrirjes
6. Sistemet e lagështimit
7. Standardet dhe etiketimi i sistemeve të ajrit të kondicionuar në ndërtesa
8. Mundësitë e kursimit të energjisë

e) Ventilatorët dhe fryrësit

1. Llojet e ventilatorëve
2. Vlerësimi i performancës së ventilatorit dhe operimi eficient i sistemit
3. Llojet e ventilatorëve dhe kriteret e përzgjedhjes. Kontrolli i rrjedhës
4. Llogaritja e performancës së ventilatorit
5. Mundësitë e kursimit të energjisë
6. Rast studimor mbi rënien e presionit në filtra

f) Pompat e fluideve të lëngshëm dhe sistemet e pompimit

1. Llojet e pompave. Karakteristika e pompës. Kurbat e funksionimit
2. Faktorët që ndikojnë në performancën e pompës
3. Operimi eficient i sistemeve të pompimit. Kontrolli i rrjedhës
4. Pompat e qarkullimit të ujit në kaldaja
5. Sistemet e pompimit të ujësjellësve të bashkive
6. Pompat e ujit të ujërave të ndotura urbane
7. Sistemet e pompimit në agrikulturë
8. Mundësitë e kursimit të energjisë në sistemet e pompimit

g) Sistemet e ndriçimit

1. Parametrat bazë të ndriçimit
2. Burimet e ndriçimit dhe llojet e llambave
3. Nivelet e rekomanduara të ndriçimit për aktivitete të ndryshme
4. Metodat e llogaritjes së ndriçimit- Projektimi i ndriçimit për ambientet e brendshme
5. Mundësitë e përgjithshme të kursimit të energjisë
6. Kontrollet eficiente të ndriçimit
7. Standardet dhe efiketimet e llambave FTL
8. Rast Studimor

h) Eficenca e sistemeve teknike në Ndërtesa

1. Përcaktimet ligjore. Kodi energjetik i banesave
2. Mbështjellja e ndërtesës
3. Sistemet teknike në ndërtesa. (HVAC)

- uji i ngrohtë sanitar
- ndriçimi
- ventilimi
- ngrohja
- ftohja

4. Energjia e lëndëve djegëse dhe energjia elektrike që konsumohet për sistemet teknike
5. Sistemet e pompimit të ujit në ndërtesë
6. Furnizimi me energji të pandërprerë
7. Sistemet e menaxhimit të ndërtesës (BMS)

8. Klasifikimi i ndërtesave sipas eficiencës
9. Masat e eficiencës në ndërtesa

i) ANEKS : Listat e protokollit për eficiencën e energjisë në pajisjet elektrike.

MODULI IV
AUDITIMI I ENERGJISË PËR SISTEMET E PAJISJEVE DHE SHËRBIMEVE NË NDËRTESA DHE INDUSTRI
(MODUL VETËM PËR AUDITUESIT)

A. Tema të përbashkëta për audituesit energjetikë

1. Përgatitja për auditimin e energjisë.
a) Përcaktimi i qëllimit të auditit.
b) Krijimi i një plani të auditit.
c) Përgatitja e listës për t'u audituar.
ç) Këqyrja dhe studimi paraprak i objektit.
d) Mbledhja e faturave të energjisë.
dh) Analiza paraprake energjetike.
e) Bilanci fillestar i energjisë.
ë) Llogaritjen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.
2. Analiza e faturave të energjisë.
a) Faturat e energjisë elektrike.
b) Faturat e gazit.
c) Faturat e naftës.
ç) Faturat e çdo lënde djegëse tjetër.
d) Analiza grafike e konsumit historik.
3. Inventari dhe matja e përdorimit të energjisë.
a) Inventari i ngarkesës energjetike.
b) Përcaktimi i flukseve (rrymave) të energjisë.
c) Matja e ngarkesave në morët elektrikë
4. Analiza e kost-benefitit për masat e eficiencës.
a) Analiza LCCA (*Life-cycle cost analysis*)
b) Metoda LCC (*Life cycle cost*).
c) Metoda NPV (*Net present value*).
ç) Metoda IRR (*Internal rate of return*).
d) Periudha e thjeshtë të vetëshlyerjes SPP (*Simple payback period*).
5. Hartimi i raportit të auditimit dhe potencialet e mundshme të kursimit.
6. Hartimi i një plani veprimi për zbatimin e masave të eficiencës.
7. Deklarimet e kursimeve të energjisë dhe ekuivalenca me reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë.
8. Analiza teknike-ekonomike e investimeve për masat e parashikuara.
9. Bazat energjetike dhe performanca e energjisë në teknologjitë tradicionale dhe inovative;
10. Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik të:
a) Sistemeve teknike të reja;
b) Sistemeve teknike ekzistuese
11. Përdorimi dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemet teknike.
12. Qëllimi i auditimit dhe shembuj praktikë.
13. Skenarët energjetikë dhe bilancet energjetike; Analiza tekniko-ekonomike e ndërhyrjeve dhe vlerësimi i potencialeve të kursimit të energjisë.
14. Energjia dhe transformimet e saj. Rekomandime për ndërhyrjet energjetike. Kostot optimale të ndërhyrjeve

15. Eficienca e energjisë dhe mbrojtja e mjedisit.

B. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në ndërtesa

1. Procedurat për certifikimin energjetik të ndërtesave sipas ligjit për PEN.
2. Standardet dhe rregulloret teknike në fushën e konsumit të energjisë në ndërtesa.
3. Detyrimet dhe përgjegjësitë e certifikuesit.
4. Konsumi i energjisë në sistemet teknike të ndërtesave rezidenciale (Ngrohja, ventilimi, kondicionimi, ndriçimi, uji ngrohtë, gatimi, larja)
5. Bilanci i energjisë i sistemit të ndërtimit (mbështjellja dhe sistemet teknike). Auditimi i konsumit dhe analiza energjetike.
6. Llogaritja e performancës energjetike të ndërtesave dhe metodologjia.
7. Analiza e ndjeshmërisë për variablat kryesorë që të ndikojë në kostot energjetike.
8. Analiza teknike-ekonomike e investimeve në ndërtesë.
9. Njohja e burimeve energjetike dhe transformimi i tyre në ndërtesë.
10. Mbështjella izoluese e ndërtimit:

a) Llojet dhe performanca e energjisë e elementëve të ndërtimit;

b) Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik e ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese.

11. Impiantet termike në ndërtesa:

a)Teknologjitë tradicionale dhe inovative në ndërtesa;

b) Zgjidhjet projektuese dhe zbatuese me qëllim optimizimin energjetik për sistemet teknike të reja dhe atyre ekzistuese.

c) Adoptimet për të rinovuar teknologjitë në ndërtesa.

ç) Përdorimi dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në sistemet teknike të ndërtesës.

d) Komforti termik në ndërtesë dhe normat e komfortit.

dh) Ventilimi natyral dhe mekanik. Rekuperatorët e energjisë.

12. Menaxhimi i energjisë të ndërtesës dhe sistemeve teknike të saj.
13. Njohja e fushëveprimit të konsumit të energjisë në sistemet Rezidenciale dhe Shërbimet.
14. Auditimi i energjisë të ndërtesave. Kriteret e auditimit dhe kërkesat më të domosdoshme për auditim.
15. Përdorimi praktik i instrumenteve matës të nevojshëm për të marrë të dhëna reale për procese të inspektimit dhe auditimit.
16. Konsumi i energjisë në banesë dhe bilanci auditues.

C. Tema specifike në fushën e auditimit energjetik në objektet dhe/ose instalimet industriale

1. Eficenca e energjisë në pajisje dhe sisteme utilitare kryesisht në industri. Njohuri të mjaftueshme në konsumin e energjisë në sistemet industriale.
2. Raporti i auditimit dhe potencialet e eficencës së energjisë në Industri.
3. Përpilimi i një raporti auditimi në ndërmarrjen industriale.
4. Rekuperuesit e energjisë në kaldaja.
5. Inventari dhe matja e përdorimit të energjisë.

a) Inventari i ngarkesës elektrike

b) Inventari i përdorimit të energjisë termike

c) Kërkesa specifike sipas sistemeve

ç) Balanca e energjisë

d) Sasia e shkarkimeve me efekt serrë.

6. Analiza e përdorimit të energjisë dhe skemat e prodhimit.

a) Profili i ngarkesës/Kërkesës

b) Skemat e dinamikës së prodhimit të energjisë

c) Interpretimi i skemave të prodhimit të energjisë.

7. Identifikimi i potencialit të kursimit të energjisë dhe të reduktimit të kostove.

a) Metodat direkte dhe indirekte të testimit të performances.
b) Kontrolli i kërkesës për energji elektrike
c) Masa të kursimit të energjisë sipas sistemeve.
- Mundësi të kursimit të energjisë në motorët elektrikë.
- Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet e ajrit të kompresuar
- Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet e pompimit
- Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet e ventilimit
- Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet e ndriçimit
- Mundësi të kursimit të energjisë në sistemet me avull.
- Mundësi të kursimit të energjisë në proceset e ngrohjes.
- Mundësi të kursimeve të energjisë sipas sektorëve specifikë.
8. Instrumentet e auditimit të energjisë në industri.
- Çështjet e sigurisë gjatë auditimit
- Matësit e parametrave elektrikë
- Matësit e temperaturës
- Matësit e rrjedhës në tuba
- Matësit e gazeve të çliruar
- Matësit e shpejtësisë së rrotullimit
9. Njohja e proceseve të përpunimit të lëndëve të para të ndërtimit dhe nevoja për energji të sistemeve industriale të prodhimit
- Industria e çimentos
- Mundësi të kursimit të energjisë në industri specifike
- Industria e hekurit dhe çelikut
- Industria tekstile
- Industria kimike e naftës dhe nënprodukteve
- Industria e qelqit
- Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve
- Sistemet e përpunimit dhe trajtimit të ujërave urbane
- Aktivitete të tjera industriale të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimet klimaterike.
10. Matja e performancës në sistemet teknike industriale:
- Sistemet e kogjenerimit
- Këmbyesit e nxehtësisë
- Motorët elektrikë dhe motorët me shpejtësi të ndryshueshme (*Variable Speed Drive*)
- Ventilatorët dhe fryrësit
- Pompat
- Kompresorët
- Impiantet e gjenerimit termik

VENDIM
Nr. 409, datë 19.6.2019

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT 2019–2021 TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit 2019–2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

DRAFT PLANI I VEPRIMIT, 2019–2021, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

PRILL, 2019

Reforma në Drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Disa prej institucioneve të reja janë ngritur dhe të tjera janë në pritje për tu ngritur. Ndërkohë që institucione që operojnë në fushën e sistemit të drejtësisë janë të angazhuara fuqishëm në aktivitetin e tyre të plotë, me qëllim për të pasur një sistem drejtësie në përputhje me standardet që një vend në pritje të hapjes së negociatave me vendet anëtare të Bashkimit Evropian duhet të ketë dhe duhet të realizojë.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 773, datë 2.11.2016, ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit. Strategjia konsiston në 8 objektiva madhorë dhe në një numër të madh masash dhe aktivitetesh për tu realizuar. Objektivat strategjikë mbulojnë çështje madhore si pavarësia, efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e institucioneve të drejtësisë; arsimi dhe kualifikimi ligjor i aktorëve të sistemit; çështje që lidhen me transparencën e sistemit; efikasiteti i drejtësisë penale dhe masave antikorrupsion; funksionalizimi i sistemit të drejtësisë nëpërmjet sistemeve elektronike dhe lehtësirave në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar; mbrojtja e të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor; funksionimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë, si dhe efikasiteti i shërbimeve të profesioneve ligjore.

Zbatimi i objektivave të Strategjisë Ndësektoriale të Drejtësisë ka qenë që në fillim të procesit në vëmendjen e Qeverisë. Krijimi dhe operimi i mekanizmit institucional të monitorimit të Strategjisë që me miratimin e saj, është një mjet që ka synuar funksionalizimin e plotë të saj dhe realizimin e masave të parashikuara. Në këtë mënyrë, konform vendimmarrjes së këtij Mekanizmi dhe në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e këtij Plani Veprimi, dhe për të pasur më shumë eficiencë në realizimin e masave u mendua një rishikim i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën e viteve 2019–2021. Për këtë qëllim, u hartua Pasaporta e Indikatorëve, në funksion të objektivave të strategjisë.

Metodologjia e ndjekur në rishikimin e këtij Plani Veprimi, ishte përfshirja e të gjithë institucioneve të fushës edhe të identifikuara në Planin e Veprimit në fuqi, marrja e kontributeve dhe parashikimeve të tyre direkte në hartim dhe zbatim të masave. Masat e parashikuara janë ideuar mbi bazë rezultati konkret, të matshëm dhe janë të kostuara. Gjatë parashikimit të masave u aplikua ndërlidhja ***objektiv-indikator-masë***. Objektivat e Strategjisë janë organizuar dhe ndarë në nënobjektiva për të bërë të mundur një organizim më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë të masave të parashikuara dhe të lidhura me to. Është aplikuar formati i parashikimit të masave me target/*milestones*.

Masat e reja të draft Planit të Veprimit, 2019–2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë synojnë të intensifikojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të reja në drejtësi, si KLGJ, KLP, ILD, KED, të SPAK e Gjykatës së

Posaçme (GJKKKO), të thellojnë formimin tekniko-profesional të sistemit të drejtësisë nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve e administratës gjyqësore apo dhe rritjen e aksesit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Ndihmës Juridike Falas. Draft Plani i Veprimit, 2019–2021, i jep një hov zhvillimi përmirësimit të gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe të tjera përmirësime në infrastrukturë. Organet e reja në drejtësi parashikohen të jenë më mirë të pajisura me kushte dhe mjete pune funksionale.

Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë, pjesë e draft Planit të Veprimit, 2019–2021, vijnë me masa konkrete në drejtim të zhvillimi strukturor, organizativ dhe thellim kapacitetesh njerëzore e profesionale për të bërë të mundur detyrimet që vijnë nga Strategjia.

Profesionet e lira ligjore janë bërë pjesë e draft Planit të Veprimit, 2019–2021, me masa të parashikuara për tu përmbushur dhe që vijnë si produkt i ndryshimeve ligjore që ligjet e tyre pësuan në kuadër të Reformës në Drejtësi, gjithashtu.

Draft Plani i Veprimit, 2019- 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konsiston në: 8 objektiva strategjikë; 11 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve; 7 indikatorë transhi të Bashkimit Evropian dhe 65 masa.

DRAFT PLANI I VEPRIMIT, 2019–2021, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Objektivat strategjikë

Strategjia ka tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë, që janë të inkorporuar në këtë Plan Veprimi, dhe që iu paraprijnë masave specifike të parashikuara.

Vizioni

1. ***Shteti ligjor garantohet nga Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, çka promovon konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe social në vend.***
2.
3. **Misioni**
4. ***Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane.***

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë

Nënobjektivi 1/a: Pavarësia e institucioneve të sistemit të drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane

Indikatori / Treguesi:

% e gjyqtarëve që besojnë se gjyqtarët janë emëruar/caktuar/promovuar jo në bazë të aftësive dhe eksperiencës në dy vitet e fundit.

Indikator transhi BE nr. 1: Institucionet e reja të drejtësisë janë krijuar dhe janë operative

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / *Milestones*			Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë)		Rezultatet
		2019	2020	2021	Në PBA	Donatorë	
1. Hartimi i bazës nënligjore për përcaktimin e kritereve dhe standardeve të meritokracisë dhe transparencës në emërimet dhe promovimet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe administratës gjyqësore.	KLGJ KLP	Kryerja e studimit të nevojshëm dhe përgatitja e draftit. Diskutimi dhe miratimi nga KLGJ e KLP. Zbatimi i standardeve	Zbatimi i standardeve	Analiza e zbatimit të standardeve		7 400	Baza nënligjore e plotësuar dhe e konsoliduar; Standardet e emërimit / promovimit të publikuara. Vendimmarrja e KLGJ e KLP mbi emërimet / promovimet

							terësisht transparente.
2. Hartimi dhe vënia në funksionim e një platforme/ metodologjie/praktike (pyetësor, sondazhi online etj) për monitorimin periodik të perceptimit të magjistratëve mbi pavarësinë e brendshme të gjyqësorit.	KLGJ KLP	Hartimi i metodologjisë dhe vënia në funksionim të sistemit të monitorimit. Kryerja e sondazhit nr. 1		Kryerja e sondazhit nr. 2		700	Metodologjia e monitorimit periodik të perceptimit të gjyqtarëve e miratuar dhe funksionale. Sondazhet e kryera dhe rezultatet e nxjerra.
3.Rritja e transparencës së vendimmarrjes në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve.	KLGJ	Publikimi i kritereve, kandidatëve, metodologjisë së vlerësimit dhe vendimmarrjes			10 000		Transparenca në vendimmarrje në procesin e emërimeve / promovimeve e siguruar.
4. Mbështetja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.	KLD/KLGJ/KLP	1/4 e subjekteve (Mbledhja e statistikave, kryerja e shortit, mbledhja e informacionit të nevojshëm, analiza e informacionit, hartimi i relacionit dhe inventarizimi i praktikës.)	1/4 e subjekteve (Mbledhja e statistikave, kryerja e shortit, mbledhja e informacionit të nevojshëm, analiza e informacionit, hartimi i relacionit dhe inventarizimi i praktikës.)	1/4 e subjekteve (Mbledhja e statistikave, kryerja e shortit, mbledhja e informacionit të nevojshëm, analiza e informacionit, hartimi i relacionit dhe inventarizimi i praktikës.)	232 000		Raporte të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit të dorëzuara në kohë.
5. Ngritja dhe vënia në funksion e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me	KED	Ngritja e KED;				13 000	Transparencanë vendimmarrje

qëllim të rishikimit të CV-ve të anëtarëve të institucioneve të drejtësisë.		Hartimi i kritereve, metodologjisë së vlerësimit dhe vënien në funksionim të sistemit. Publikimi i kritereve të hollësishme, kandidatëve, metodologjisë së vlerësimit dhe vendimmarrjes Vënia e KED në funksionim të plotë;					për procesin e përzgjedhjes është e garantuar.
Nënobjektivi 1/b: Përmirësimi i eficencës së sistemit të drejtësisë							
10. Forcimi i kapaciteteve profesionale të përmbaruesve gjyqësore privatë 10.1 planifikimi i trajnimeve sipas nevojave, mbështetur në analizën e ankesave dhe mangësive të konstatuara nga DHKPGJP dhe MD gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së përmbaruesve gjyqësorë privatë; 10.2 Përgatitja e kurrikulave të trajnimit; 10.3 Organizimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme (në varësi dhe të ndryshimeve ligjore);	DHKPGJP MD	(10.1) Evidentimi fushave dhe tematika më kryesore ku nevojitet zhvillimi i trajnimeve. (10.2) Përgatitja e kurrikulave të trajnimit. (10.3) Parashikim i qartë i numrit të orëve për trajnime vazhduese; Zhvillimi i të paktën 2 trajnimeve vazhduese gjatë vitit.	(10.2 dhe 10.3) Rishikim periodik i kurrikulave të trajnimit, sipas nevojave në zhvillim.			7 000	Trajnime periodike për përmbaruesit gjyqësorë privatë. Qendra për organizimin e trajnimeve periodike pranë DHKPGJP-së (ose dhe fillestare, në varësi të ndryshimeve ligjore), e ngritur dhe funksionale.

10.4 Përllogaritje e kostove të funksionimit të qendrës së trajnimeve; 10.5 Ngritjen e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.		(10.4) Kosto e përllogaritur për ngritjen e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë. (10.5) Evidentimi dhe sigurimi i infrastrukturës mbështetëse për qendrën e trajnimeve pranë DHKPGJP; Struktura e miratuar për qendrën e trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë; Rregullore e miratuar mbi organizimin dhe funksionimin e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.	Qendra e Trajnimeve pranë DHKPGJP-së, funksionale dhe në shërbim të trajnimit periodik të përmbaruesve.				
11. Garantimi i procedurave të shpejta të ekzekutimit, përmes administrimit të informacionit. 11.1 Kryerja e një analize mbi nevojën e zgjerimit të aksesit në bazat e të dhënave	DHKPGJP MD	(11.1) Kryerja e një analize mbi nevojën e				90 000	Akses në kohë reale në informacion, me qëllim përmbushjen e detyrave

shtetërore të shërbimit përmbarimor gjyqësor; 11.2 Nxitja e lidhjes së marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit; 11.3 Ndërveprimi në kohë reale i sistemeve elektronike të shërbimit përmbarimor me sistemet të tjera shtetërore dhe baza të dhënash shtetërore dhe/ose me ente private.		zgjerimit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore të shërbimit përmbarimor gjyqësor. (11.2) Marrëveshjeve të lidhura dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit. (11.3) Ndryshimet e nevojshme ligjore dhe teknike të realizuara, për ndërveprimin në kohë reale i sistemeve elektronike të shërbimit përmbarimor me sistemet të tjera shtetërore dhe baza të dhënash shtetërore dhe/ose me ente private.					procedural për ekzekutimin e titujve.

Nënobjektivi 8/b: Krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin							
Indikatori / Treguesi: -							
Masat / Aktivitetet e parashikuara	**Institucioni Përgjegjës**	**Targeti / *Milestones***			**Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë)**		**Rezultatet**
		2019	**2020**	**2021**	**Në PBA**	**Donatorë**	
1. Hartimi i kuadrit ligjor vendas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike me arbitrazh.	MD Kuvendi	Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh" ; Miratimi i akteve nënligjore të parashikuara;	Njoftimi publik dhe ndërmarrja e aktiviteteve njoftuese për zbatimin e zgjidhjeve me arbitrazh; Trajnime;	Aplikimi zgjidhjeve me arbitrazh;	2 332		Kuadër ligjor në fuqi dhe ofrim zgjidhjes mosmarrëveshjesh juridike me arbitrazh.

VENDIM
Nr. 413, datë 19.6.2019

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2019–2023 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit.
2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT
2019–2023

Pasqyra e Lëndës:

1. Parathënie nga Ministri
2. Analiza e Situatës Aktuale të Sektorit të Turizmit
2.1. Një vëzhgim i përgjithshëm i sektorit
2.2. Analiza e Komponentëve
2.2.1. Produktet turistike
2.2.2. Atraksionet Turistike
2.2.3. Infrastruktura turistike
2.2.4. Kapacitetet akomoduese, agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë
2.3. Vlera e Turizmit në Ekonomi
2.3.1. Rëndësia e Sektorit të Turizmit në Ekonominë e Shqipërisë
2.3.2. Burimet njerëzore për turizmin
2.4. Problemet dhe Sfidat e Sektorit
2.4.1. Problemet e Identifikuara ndër Vite
2.4.2. Sfidat e së Ardhmes
3. Vizioni i Strategjisë 2019-2023
3.1. Deklarata e Vizionit
3.2. Misioni
3.3. Synimi
3.4. Qëllimet Strategjike
4. Objektivat e Politikës dhe Objektivat Specifikë
4.1. Objektivi Politik 1: Nxitja e Investimeve Publike dhe Private
4.2. Objektivi Politik 2: Përmirësimi i Shërbimeve Turistike
4.3. Objektivi Politik 3: Konsolidimi dhe Zhvillimi i Produkteve Turistike.
4.4. Objektivi Politik 4: Ri-orientimi i Promovimit drejt Potencialeve Turistike.
4.5. Objektivi Politik 5: Mbështetje për Menaxhimin e Destinacioneve.
4.6. Outputet Ekonomike
5. Burimet Financiare
6. Zbatimi dhe Monitorimi

1. Parathënie nga Ministri

Tanimë, nuk ka asnjë dyshim që turizmi po hyn në kryefjalën e zhvillimit ekonomik, social dhe kombëtar të vendit tonë.

Të dhënat vit pas viti dëshmojnë ngjitjen e turizmit si një ndër sektorët që sjellin më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, buxhetin sipërmarrës dhe atë familjar, me një kontribut direkt në PBB prej 8,5% dhe një vlerë të shtuar indirekte prej 26,2%. Turizmi është po ashtu edhe sektori që ka potencialin më të lartë të punësimit, nga ku 93 mijë kanë qenë të punësuarit direkt dhe mbi 291 mijë ishin të punësuarit total në këtë sektor përgjatë 2017-s.

Kjo do të thotë se vlera e shtuar e këtij sektori ka një rëndësi ekonomike dhe strategjike për vendin, pasi për çdo 1 lek të investuar, krijohen 3 lekë vlerë e shtuar dhe për çdo 1 të punësuar në këtë sektor, hapen 3 vende të reja pune.

Megjithatë, duket se deri tani betejën e statistikave e kemi fituar. Por në kushtet e një turizmi të ndërtuar për një kohë të gjatë në mënyrë individuale dhe pa vizion, vërejmë se ka akoma shumë potenciale ende të pashfrytëzuara, të cilat nëse programohen siç duhet, mund ta kthejnë këtë sektor në një ndër shtyllat më të forta konkurruese të vendit, në rajon e më gjerë.

Këtë synojmë të arrijmë përmes kësaj strategjie. Kemi paraqitur tanimë një vizion të

qartë për ta kthyer Shqipërinë në një destinacion të vlerës më të mirënjohur Shqiptare, atë të mikpritjes, nga ku do të punojmë për krijimin e destinacioneve të reja gjithëvjetore. Do të ndërtojmë instrumente për rritjen e vlerës së shtuar sidomos për ekonomitë familjare, do të zhvillojmë produkte të reja turistike, si dhe përmirësojmë ndjeshëm shërbimin, në mënyrë që të gjithë së bashku të promovojmë një Shqipëri vlerash të shëndetshme për një të ardhme më të bukur për ne dhe fëmijët tanë.

Blendi Klosi
Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023

Vizioni

"Shqipëria, një destinacion mikpritës, tërheqës dhe autentik, për zhvillim të qëndrueshëm të potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit".

Misioni

Zhvillimi i destinacioneve, zonave, produkteve dhe diversifikimi i ofertës turistike	Rritja e vlerës së shtuar të potencialeve turistike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit

Nënsektorët

BREGDETAR	NATYROR	TEMATIK
1. Bregdetar 2. Detar (maritime)	3. Turizmi malor 4. Ekoturizmi (flora/ fauna) 5. Bregujor	6. Kulturor 7. Agroturizëm 8. MICE 9. Eno-Gastronomi 10. Shëndetësor

Qëllimet strategjike

Krijimi i poleve dhe industrive të reja të zhvillimit, si dhe konsolidimi i ofertës turistike	Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim	Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i cilësisë së tyre	Përmirësimi i imazhit të vendit dhe promovimi i produkteve lokale

Objektivat e politikës dhe objektivat specifikë

Nxitje e **investimeve** publike - private	Përmirësimi i **shërbimeve** turistike	Zhvillimi i **produkteve** turistike	Riorientim i **promovimit** drejt potencialeve	Mbështetje për **menaxhimin** e destinacioneve
Nxitja e investimeve strategjike private, si dhe tërheqja e markave të mirënjohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm	Formalizim, standardizim dhe mbështetje për veprimtaritë turistike	Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar dhe krijimi i produkteve të reja	Hartimi i Strategjisë së Brandit dhe Marketingut të Turizmit	Zhvillimi i modelit të menaxhimit të destinacioneve
Përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe orientimi i investimeve private drejt tyre	Krijimi i Kuadrit Rregullator dhe Institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor	Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi i produkteve të reja	Promovimi i Produkteve Turistike gjithëvjetore brenda dhe jashtë vendit	Konsolidimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin dhe operimin e Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve

Orientimi i investimeve publike drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike për përmirësimin e infrastrukturës bazë në to	Hartimi i kuadrit rregullator dhe institucional për zhvillimin e shërbimeve dhe mënyrën e operimit të Porteve Turistike dhe aktiviteteve në funksion të tyre	Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik dhe krijimi i produkteve të reja	Mbështetja e Agjentëve Promovues të vendit në Shqipëri dhe Diasporë	Monitorimi dhe Mbështetja e Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve

2. Analiza e Situatës Aktuale të Sektorit të Turizmit

2.1 Një vëzhgim i përgjithshëm i sektorit

Vit pas viti, turizmi po kristalizohet gjithnjë e më shumë si një ndër motorët më kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Sipas Raportit të Impaktit Ekonomik të Udhëtimeve dhe Turizmit 2018, të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit[4] (WTTC), përgjatë vitit 2017, sektori i turizmit regjistroi një kontribut direkt prej 1.12 bln$ duke përbërë rreth 8.5% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërkohë duke përfshirë edhe efektet indirekte multiplikative, kontributi total është thuajse trefish më i lartë prej 3.47 bln$, duke përbërë rreth 26.2% të PBB-së, duke e pozicionuar këtë sektor si një ndër kontribuesit kryesor të zhvillimit të ekonomisë kombëtare.

Ndërkohë për 10-vjeçarin e ardhëm parashikohet një rritje e konsiderueshme e kontributit të këtij sektori në ekonomi, ku vetëm në 2-3 vite sektori i turizmit pritet të zërë 8,8% të PBB ndërkohë që deri në 2028, sektori mund të zërë deri në 9.3 % të PBB. Kësisoj, duke marrë në konsideratë këtë trend rritës, parashikohet që deri në 2028 efekti direkt dhe indirekt i sektorit të turizmit t`i afrohet rreth 1/3 të të gjithë Produktit të Brendshëm Bruto të Shqipërisë.

Po ashtu, referuar punësimit, aktualisht në sektorin e turizmit janë punësuar rreth 7.7% e të gjithë forcës së punës në Shqipëri, ndërkohë që deri në 2028 parashikohet që ky numër të rritet në nivelin 8.8 %. Referuar të njëjtit raport të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC), investimet në këtë sektor përbënin rreth 7.5 % të të gjithë investimeve në vend, ndërkohë që deri në 2028 parashikohet që kjo shifër të rritet në nivelin 8,2%.

Sipërmarrjet e akomodimit dhe të shërbimeve në funksion të turizmit janë rritur gjithashtu në trende konstante pozitive përgjatë gjithë viteve të fundit, ku nga 18,061 sipërmarrje që numëroheshin në 2014, numri shkoi rreth 22,785 më 2017. Sektori i shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit përfshin restorantet, struktura të tjera ushqimi, si dhe struktura akomoduese të tipit hotel, bujtinë, hostel etj. Ky sektor përbën rreth 15% të gjithë sektorit të shërbimeve, si dhe 11% të të gjithë aktiviteteve ekonomike në Shqipëri.

Evropa është burimi kryesor i turistëve që vizitojnë Shqipërinë[5] duke zënë një volum prej rreth 92.4% të të gjithë turistëve, çka reflekton se aksesi >3 orë nga një destinacion në tjetrin është ende faktor i rëndësishëm për fluksin e udhëtarëve për qëllime turizmi. Megjithatë së fundmi turistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo Azia dhe veçanërisht Kina, kanë shënuar një interes domethënës rritës, duke inkurajuar kështu indirekt zhvillimin e nënsektorëve të tjerë të turizmit, sidomos turizmin historik dhe atë kulturor.

Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera të pellgut mesdhetar, zhvillimi i turizmit në Shqipëri është ende larg potencialit që përfaqësojnë pasuritë natyrore, historike e kulturore të vendit. Infrastruktura, kapacitetet akomoduese, cilësia e shërbimeve, oferta dhe produkti turistik janë që të gjithë faktorë që kanë frenuar disi zhvillimin e qëndrueshëm e konsistent të turizmit në Shqipëri, duke i lënë vend një zhvillimi të pakontrolluar e kaotik që faktikisht e ka mbajtur në këmbë këtë industri, por duke rrezikuar qëndrueshmërinë e tij në terma afatgjatë.

2.2 Analiza e komponentëve

2.2.1 Produktet turistike

Për nga kontributi që kanë në të ardhurat e turizmit, produktet turistike mund t'i ndajmë në tre kategori kryesore. Këto kategori konsistojnë në ato forma të zhvillimit të turizmit të cilat zënë

[4] https://www.wttc.org/-/media/files/reports/economic-impact-research/countries-2018/albania2018.pdf

[5] http://instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2018.pdf

një peshë të rëndësishme në kontributin e sektorit në totalin e ekonomisë. Produktet kryesore mund të klasifikohen si më poshtë:

Turizmi bregdetar – Kjo kategori përfshin turizmin bregdetar dhe turizmin detar (maritime). I pari u referohet aktiviteteve që zhvillohen në buzë të detit ose që afërsia me të është baza e organizimit të tyre, si noti, banjot e plazhit dhe aktiviteteve të tjera rekreative të lidhura me to, ndërsa i dyti u referohet aktiviteve që zhvillohen në det, ku përfshihen lundrimi turistik (*yachting, sailing, cruising*), portet turistike të jahteve me gjithë shërbimet dhe aktivitetet e lidhura me to, dhe sportet detare.

Plazhi, deti dhe dielli është prej vitesh produkti kryesor që zë peshën më të madhe në totalin e produkteve turistike. Ky lloj turizmi në Shqipëri ka një karakter të theksuar sezonal, e për rrjedhojë shumica e strukturave akomoduese në zonën bregdetare përballen me vështirësi sezonale të funksionimit. Ndërkohë, për turizmin e detar (maritime), infrastruktura aktualisht mungon dhe ky segment (*yachting, sailing, cruising*) është ende në fillesat e veta, por potenciali për tu zhvilluar është shumë i madh dhe shumë i rëndësishëm për ekonominë dhe turizmin elitar në Shqipëri.

Turizmi natyror – Shqipëria është vlerësuar nga shumë operatorë dhe vizitorë ndërkombëtarë për natyrën dhe pejsazhet e saj të bukura. Zonat natyrore dhe rurale në Shqipëri ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, malor, ekoturizmit dhe veprimtarive në natyrë (rafting, hedhje me parashutë sportive, çiklizmi malor, peshkimi, trekking, ngjitjet alpinistike, ecja në natyrë-hiking, shëtitja me kuaj, turet studimore etj.). Disa prej këtyre veprimtarive janë motivi kryesor i vizitave nga vizitorët e huaj në zonat natyrore.

Sa i përket turizmit malor ka pasur zhvillime pozitive, si rrjedhojë e të cilave janë stabilizuar një numër i konsiderueshëm turesh të organizuara në Theth, Vermosh-Lepushë, Valbonë dhe Tropojë, në Alpet Shqiptare, Dibër dhe zonën e Bulqizës, zonën malore të Tiranës, zonën malore të Elbasanit dhe Librazhdit, zonën malore të Korçës, malin e Tomorit, Llogara dhe Karaburun dhe zonën malore të Gjirokastrës dhe Përmetit. Nga ana tjetër, kësaj kategorie i shtohet edhe turizmi në zonat e mbrojtura mjedisore.

Baza e sistemit të zonave të mbrojtura mjedisore konsiston në 15 parqe kombëtare, disa rezervate natyrore të menaxhuara e peizazhe të mbrojtura, në të cilat gjenden vlerat më të mëdha natyrore dhe biodiversitetit në vend. Vitet e fundit këto zona po tërheqin gjithnjë e më shumë vizitorë, vendas apo të huaj, duke arritur në mbi 2,4 milionë në vitin 2018.

Turizmi tematik – Në këtë kategori përfshihen një sërë formash specifike të turizmit, si agroturizmi, turizmi i eventeve dhe biznesit, turizmi kulturor (trashëgimi, histori, besim etj.), turizmi enogastronomik dhe turizmi shëndetësor (termal, mirëqënies dhe mjekësor) etj. Edhe pse nuk është qëllimi kryesor i vizitës në Shqipëri, arkeologjia, trashëgimia e kultura identifikohen si pikat e forta të Shqipërisë në studime të ndryshme të kryera me vizitorë dhe industrinë e udhëtimeve nga tregjet e huaja. Destinacionet kryesore të vizituara nga ture të organizuara kulturore janë Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora.

Sa i përket turizmit të biznesit, zhvillimet në këtë drejtim janë të përqëndruara në nivel kombëtar dhe mungesa e një rrjeti të konsoliduar bashkëpunimi mes aktorëve, së bashku me mungesën e qendrave të reja për organizimin e konferencave dhe kongreseve, qendrave të biznesit pranë poleve të zhvillimit ekonomik (Aeroporti i Rinas-it), strukturave akomoduese të markave të njohura ndërkombëtare në organizimin e konferencave e kongreseve, ka kufizuar perspektivën e zhvillimit të turizmit MICE në nivel ndërkombëtar.

E gjendur në një pozicion të favorshëm në tregun rajonal të Ballkanit dhe disa tregje të rëndësishme Evropiane, me teknologji dhe *know how* të zhvilluar në disa prej sektorëve të mjekësisë (kujdesin stomatologjik, kirurgjinë plastike, kirurgjinë kardiovaskulare dhe neurokirurgjinë, trajtimin e fertilitetit), burimet natyrore dhe kushtet klimaterike të favorshme për zhvillimin e disa drejtimeve të këtij segmenti (thalasoterapi, terapi me ujërat termale), çmimet konkurruese, Shqipëria ka pasur zhvillime pozitive në segmentin e turizmit të shëndetit dhe mirëqënies.

2.2.2 Atraksionet turistike

Shqipëria përfshihet në listën e vendeve me potenciale të mëdha natyrore, historike dhe të

trashëgimisë kulturore. Në Shqipëri ka një numër të madh atraksionesh natyrore, që nga bregdeti i Adriatikut e ai i Jonit deri te parqet kombëtare e natyrore, zonat e mbrojtura, ligatinat etj. Këtu mund të përmendim Parkun Kombëtar të Divjakës, Prespës, Dajtit, Karaburun – Sazanit, lagunën e Kune – Vain – Tale etj. Zonat përreth lumenjve dhe ligatinave përbëjnë një potencial të madh për zhvillimin e turizmit.

Në Shqipëri ka rreth 2000 monumente kulture, duke e renditur atë në vendin e dytë në pellgun e Mesdheut për nga dendësia e monumenteve të kulturës. Ndërkohë Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës dhe Butrinti janë pjesë e trashëgimisë botërore dhe mbrohen nga UNESCO. Edhe parqet arkeologjike të Apolonisë, Shkodrës, Bylisit, Amantia dhe muzetë kombëtarë në Tiranë, Krujë (Muzeu "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" dhe Muzeu Etnografik), Berat (Muzeu Ikonografik "Onufri" dhe Etnografik), Shkodër (Muzeu Marubi), Korçë (Muzeu i Artit Mesjetar) etj. përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm të ofertës turistike.

Megjithatë, siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme, numri i vizitorëve në këto atraksione kulturore është mjaft i ulët. Edhe nëse do të konsideronim sikur këto atraksione vizitohen vetëm nga turistë të huaj, prapë vetëm 10% e tyre vizitojnë edhe atraksionet kulturore dhe sërish këtu ka mjaft vend për rezerva pasi një pjesë jo e pakonsiderueshme e vizitorëve janë shtetas shqiptarë.

Trendi i vizitueshmërisë (vizitorë në total) në periudhën janar – dhjetor në vitet 2014-2018 ka shënuar rritje progresive (në %) si më poshtë:

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017, vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 49%.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2016 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 82%.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 115%.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2014 vizitueshmëria gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje prej 127%".

Tabela 1. Nr. i vizitorëve në Muze Kombëtare, parqe arkeologjike dhe monumente të kulturës[6]

Vizitorët	2014	2015	2016	2017	2018
Vendës	134,747	148,669	185,878	208,857	263,399
Të huaj	176,648	238,187	282,157	352,025	516,943
Totali	**404,244**	**463, 682**	**549, 697**	**669, 110**	**998,441**

2.2.3 Infrastruktura turistike

Në ndryshim nga situata me potencialet natyrore, historike dhe kulturore, Shqipëria ka mbetur mbrapa në ndërtimin e infrastrukturës turistike si qendra moderne kongresesh, parqe argëtuese dhe rekreacioni, fusha (kurse) golfi, marina etj., pa të cilat është e vështirë të tërheqësh segmente të caktuara të kërkesës turistike dhe për të mundësuar shtrirjen gjithëvjetore të turizmit. Gjithashtu, në Shqipëri, mungojnë qendrat për zhvillimin e turizmit malor dhe të aventurës, qendrat e zhytjes argëtuese, shtigjet e biçikletave etj., të cilat do ta pozicionin Shqipërinë në tregun e turizmit të interesit të veçantë.

2.2.4 Kapacitetet akomoduese, agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë

Aktualisht, në gjithë vendin operojnë 2,437 struktura akomoduese,. Hotelet përbëjnë rreth 65% të totalit, ndërsa pjesa tjetër janë shtëpi e dhoma. Gjithashtu, sipas të dhënave të QKB, në vend janë licencuar 75 operatorë turistikë dhe 322 agjenci udhëtimi me një shpërndarje të ndryshme në qarqe, me pjesën dërrmuese të tyre të përqëndruar në Tiranë. Në Shqipëri, bazuar në kuadrin ligjor, deri në 3-mujorin e tretë të vitit 2018, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit janë certifikuar 306 udhërrëfyes turistikë, nga të cilët 156 udhërrëfyes kombëtarë, 78 udhërrëfyes lokalë, 69 udhërrëfyes të specialitetit të veçantë dhe 3 udhërrëfyes nderi.

[6] *Në numrin e vizitorëve është përfshirë numri i atyre që hyjnë pa biletë (hyrje falas)*

2.3 Vlera e turizmit në ekonomi

2.3.1 Rëndësia e Sektorit të Turizmit në Ekonominë e Shqipërisë

Sipas vlerësimeve të Këshillit Botëror të Turizmit dhe Udhëtimeve (WTTC), gjatë vitit 2017 kontributi direkt i turizmit në PBB-në e vendit ka qenë 134.1 miliardë lekë ose 8.5% të PBB-së së vendit. Në krahasim me një vit më parë ky kontribut është rritur me 12.6 miliardë lekë dhe ka një rritje konsistente vit pas viti, siç mund të shihet edhe në tabelën më poshtë.

Tabela 2. Kontributi direkt i turizmit në PBB-në e Shqipërisë (në mld ALL dhe në %)

Vitet	2014	2015	2016	2017
Kontributi direkt në PBB	117.2	118.7	130.3	134.1
Përqindja e zënë në PBB e vendit	8.4%	8.3%	8.8%	8.5%

Burimi: WTTC

Kontributi total në PBB mat kontributin e drejtpërdrejtë të sektorit të udhëtimeve dhe turizmit së bashku me impaktin e tij më të gjerë në një sërë aktivitetesh ndihmëse. Sipas vlerësimeve të WTTC, gjatë vitit 2017 kontributi total i turizmit në PBB-në e vendit tonë ka qenë 414.2 miliardë lekë ose 26.2% të PBB-së të vendit.

Tabela 3. Kontributi total i turizmit në PBB-në e Shqipërisë (në mld ALL dhe në %)

Vitet	2014	2015	2016	2017
Kontributi total në PBB	357.2	364.2	397.4	414.2
Përqindja e zënë në PBB e vendit	25.6%	25.3%	26.9%	26.2%

Burimi: WTTC

Sipas parashikimeve afatgjata të kësaj organizate, në vitin 2028, parashikohet që kontributi direkt i turizmit në PPB-në e vendit të jetë 220.4 miliardë lekë ose 9.3% të PPB-së, ndërsa kontributi total në PPB parashikohet të jetë 684.2 miliardë lekë ose 28.9% të PPB-së.

Nga ana tjetër, bazuar në raportin e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, të hyrat sa i përket turizmit dhe udhëtimeve për vitin 2017 kanë qenë pozitive, duke shënuar një nivel prej 1,7 miliardë euro me një rritje prej rreth 13% krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat neto nga udhëtimi/turizmi në vitin 2017 kanë arritur vlerën 445 milionë euro, me një rritje të konsiderueshme krahasuar me 389 milionë euro që kanë qenë në vitin 2016. Shumë premtues është dhe fillim viti i 2018. Të hyrat për sa i përket turizmit dhe udhëtimit vetëm në nëntëmujorin e vitit 2018 është 1,4 miliardë euro. Të ardhurat neto nga udhëtim/turizëm nga janari deri në shtator 2018 kanë arritur vlerën 659 milionë euro me një rritje prej 48% krahasuar me vitin e plotë të 2017.

Grafiku 1. Të ardhurat neto nga turizmi (në mln euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Ky trend rritës i të ardhurave neto, i cili vijon që nga viti 2014, tregon një rritje në të gjithë zinxhirin e vlerës së produktit turistik.

Kohëqëndrimi mesatar i vizitorëve përgjatë vitit 2017 ka mbetur pothuaj konstant, rreth 5.6 net për arsye personale dhe rreth 4.3 net për arsye biznesi. Numri i netqëndrimeve të vizitorëve jorezidentë për vitin 2017, ka shënuar një ulje të lehtë krahasuar me një vit më parë duke arritur në 26,824,434 net.

Grafiku 2. Nr. i netqëndrimeve të turistëve të huaj



Burimi: Vlerësime të MTM me të dhënat e Bankës së Shqipërisë

Numri i vizitorëve jorezidentë ka shënuar një rritje të vazhdueshme vit pas viti duke arritur në mbi 5 milionë gjatë vitit 2017. Sipas të dhënave zyrtare, çdo vit Shqipëria është vizituar nga rreth 500,000 turistë më shumë se gjatë vitit pararendës. E ndërsa vendi po fiton vëmendje në median ndërkombëtare, pritshmëritë janë që numri i vizitorëve të rritet akoma më shumë.

Tabela 4. Hyrjet e jorezidentëve në Shqipëri

Periudha	Hyrje të jorezidentëve				
	2014	2015	2016	2017	2018
3-mujori I	481,136	487,271	561,948	601,940	676, 888
3-mujori II	815,196	973,362	1,038,747	1,157,354	1,242,616
3-mujori III	1,779,569	2,004,786	2,395,917	2,465,389	3,142,318
3-mujori IV	596,690	665,823	738,899	893,017	864,981
GJITHSEJ	**3,672,591**	**4,131,242**	**4,735,511**	**5,117,700**	**5,926,803**

Burimi: INSTAT

Sa i përket mënyrës së transportit të vizitorëve të huaj, të dhënat tregojnë se pjesa dërrmuese e tyre vazhdojnë të hyjnë në Shqipëri në rrugë tokësore. Kësisoj, gjatë vitit 2017, 81% e vizitorëve jorezidente kanë hyrë në Shqipëri në rrugë tokësore, 11.3% në rrugë ajrore dhe vetëm 7,7% në rrugë detare.

Grafiku 3. Turistët e huaj sipas mënyrës së udhëtimit (në %)

Nëse shohim seritë kohore të të dhënave, vihet re se, vitet e fundit, numri i turistëve që vijnë në Shqipëri në rrugë detare dhe ajrore ka pasur një rritje jashtëzakonisht të lartë, çka tregon se turizmi shqiptar po eksploron tregje përtej tregjeve tradicionale në vendet fqinje. Kështu, në vitin 2017, numri i vizitorëve që hynë në Shqipëri në rrugë detare ishte 42,6% më i lartë se një vit më parë, ndërsa numri i vizitorëve që hynë në rrugë ajrore 26,5% më i lartë se një vit më parë.

Tabela 5. Nr. i vizitorëve jorezidentë sipas mënyrës së udhëtimit

Mënyra e udhëtimit	2014	2015	2016	2017	2018
Me ajër	337,161	400,742	456,931	577,844	691,550
Me det	197,919	211,556	275,574	393,013	439,331
Me tokë	3,137,511	3,518,944	4,003,006	4,146,843	4,795,922
TOTALI	**3,672,591**	**4,131,242**	**4,735,511**	**5,117,700**	**5,926,803**

Përtej përpjekjeve për të eksploruar tregje të reja edhe përtej kontinentit, Shqipëria mbetet shumë e varur nga vizitorët evropiane. Kështu, gjatë vitit 2018, 90,% e turistëve që vizituan Shqipërinë ishin nga rajoni i Evropës, me një rritje prej 13,8% krahasuar me një vit më parë. Për më shumë detaje, tabela e mëposhtme.

Tabela 6. Nr. i vizitorëve jorezidentë sipas vendit të origjinës

Rajoni	2015	2016	2017	2018
Afrika	2,973	1,077	2,080	3,457
Amerika	96,763	103,839	123,729	148,845
Azia Lindore dhe Paqësori	33,032	35,894	53,533	68,121
Lindja e Mesme	3,604	4,324	4,722	7,174
Azia Jugore	1,636	1,699	2,216	3,115
Evropa	3,759,423	4,485,405	4,686,695	5,331,614
Evropa Qendrore/Lindore	151,457	182,581	269,261	362,083
Evropa Veriore	125,513	149,965	204,099	212,246
Evropa Jugore	3,169,174	3,855,617	3,810,337	4,301,996
Evropa Perëndimore	246,811	221,492	316,120	357,411
Evropa Lindore/Mesdhetare	66,468	75,750	86,878	97,878
Rajone të paspecifikuara	233,811	103,273	244,725	364,477
GJITHSEJ	**4,131,242**	**4,735,511**	**5,117,700**	**5,926,803**

2.3.2 Burimet njerëzore për turizmin

Gjatë vitit 2017 industria e turizmit dhe udhëtimeve ka gjeneruar në mënyrë direkte 93,500 vende pune, duke zënë kështu 7.7% në punësimin total dhe shënuar një rritje prej 4.1 % në krahasim me një vit më parë.

Tabela 7. Kontributi direkt i turizmit në punësim

Vitet	2014	2015	2016	2017
Kontributi në punësim	76,100	79,200	89,800	93,500
Përqindja e zënë në punësimin në total	7.3%	7.3%	7.7%	7.7%

Burimi:WTTC

Në mënyrë indirekte, gjatë vitit 2017, industria e turizmit dhe udhëtimeve ka gjeneruar, në total, 291,600 vende pune, duke përbërë kështu 24.1% të punësimit total, me një rritje prej 5.2% në krahasim me një vit më parë.

Tabela 8. Kontributi total i turizmit në punësim

Vitet	2014	2015	2016	2017
Kontributi në punësim	237,700	246,000	277,200	291,600
Përqindja e zënë në punësimin në total	22.8%	22,7%	23.9%	24.1%

Burimi: WTTC

Turizmi ka një potencial për të gjeneruar edhe më shumë vende pune në të ardhmen, por nga ana tjetër nevojitet domosdoshmërisht arsimimi dhe trajnimi i punonjësve të sektorit turistik në mënyrë që shërbimi që u jepet vizitorëve të jetë profesional.

2.4 Problemet dhe sfidat e sektorit

2.4.1 Problemet e identifikuara ndër vite

Një numër problemesh e sfidash që shoqërojnë zhvillimin e turizmit janë identifikuar në vite. Një numër i tyre mbetet për t'u adresuar edhe më tej, ndërsa ky dokument strategjik synon të gjejë përgjigje sistematike për adresimin e tyre. Turizmi në Shqipëri përballet me këto probleme:

Mungesa e kapaciteteve akomoduese dhe mungesa e akomodimit cilësor

Në zonat që tërheqin më shumë turistë, qofshin këto bregdetare apo jo, numri i shtretërve është shumë i limituar dhe për më tepër me mesatare të ulët për njësi, çka sigurisht që ka efektin e vet edhe mbi numrin total të vizitorëve. Kësaj i shtohet edhe fakti se në shumicën e destinacioneve turistike, strukturat akomoduese janë më së shumti shtëpi private, apartamente e dhoma, të cilat ofrojnë kushte shumë minimale e shërbime të cunguara.

Mungesa e "markave" të njohura hoteliere dhe operatorëve turistikë

Markat e njohura të hotelerisë dhe operatorëve turistikë, për pjesën dërrmuese të turistëve të huaj janë një garantues i cilësisë së shërbimit e, njëkohësisht, shërbejnë edhe si garantues të besueshmërisë së një destinacioni. Aktualisht, në Shqipëri, nuk operojnë marka ndërkombëtare të hotelerisë, as në qytetet kryesore e as në zonat turistike.

Mungesa e infrastrukturës turistike

Në Shqipëri, përveç bukurive natyrore, infrastruktura shtesë turistike thuajse nuk ekziston fare. Parqet argëtuese dhe ato të rekreacionit, qendrat e konferencave e panaireve, portet e jahteve nga ku mund të nisen mjetet lundruese për turizmin nënujor apo për turizmin detar etj. nuk janë thuajse fare të pranishme.

Mungesa e standardizimit dhe sistemit të klasifikimit

Në Shqipëri strukturat akomoduese dhe ofruesit e shërbimeve të tjera turistike nuk janë të klasifikuara në bazë të standardeve për shërbimet që ato ofrojnë.

Sezoni i shkurtër turistik

Ndonëse Shqipëria ka një klimë tipike mesdhetare çka bën që vendi ynë të gëzojë plot 250 ditë diell, përsëri sezoni turistik në Shqipëri kufizohet vetëm në muajt korrik dhe gusht. Ndonëse kërkesa për shërbime është aty për një periudhë të gjatë të vitit, oferta mungon pasi zhvillimi sporadik i deritanishëm, i ka dhënë

turizmit një karakter mjaft sezonal. Që kjo industri të kthehet në një nga shtyllat e ekonomisë shqiptare, duhet që efektet sezonale të turizmit bregdetar të zbuten nëpërmjet zhvillimit të formave të tjera të turizmit, duke rritur numrin e vizitorëve, netqëndrimet e rrjedhimisht edhe të ardhurat nga turizmi.

Informaliteti në veprimtaritë turistike

Shumë nga strukturat akomoduese, por edhe ofrues të tjerë shërbimesh, si restorante apo udhërrëfyes turistikë, operojnë në informalitet të plotë duke krijuar terrenin për shërbime të një cilësie të ulët, duke ndikuar në sigurinë e turistëve dhe në imazhin e vendit.

Zgjidhja e problemit të pronësisë

Ashtu si shumë sektorë të tjerë të ekonomisë shqiptare, edhe turizmi është penguar ndjeshëm nga problemet e pronësisë. Moszgjidhja e këtyre problemeve dhe konfliktet e shumta sociale e jo vetëm, që i shoqërojnë ato kanë mbajtur larg shumë investitorë të mëdhenj, vendas e të huaj dhe kanë bllokuar shumë projekte madhore në fushën e turizmit.

Mungesa e investimeve kapitale private pengon konsolidimin e sektorit

Thuajse në gjithë zonën bregdetare, por edhe në shumë nga qytetet e tjera me potencial për turizmin, investimet e bëra deri tani, me ndonjë përjashtim, janë të vogla, çka ka bërë që sektori të jetë i pakonsoliduar. Që oferta turistike e Shqipërisë të mos jetë sporadike, duhet domosdoshmërish që ky sektor të konsolidohet duke tërhequr investitorë të mëdhenj e të besueshëm e duke nxitur projekte madhore e strategjike.

Mungesë e theksuar e trajnimit të të punësuarve në sektorin e turizmit

Për sa u përket burimeve njerëzore dhe shërbimeve që u ofrohen turistëve, ato lënë shumë për të dëshiruar dhe nevojitet domosdoshmërish një program trajnimi për të nxitur një hop cilësor në turizëm.

Lidhje të pakta përmes transportit ajror dhe detar

Portet dhe aeroportet e Shqipërisë ofrojnë mundësi të pakta udhëtimi për vizitorët e huaj. Me përjashtim të Italisë, fluturimet direkte dhe lidhjet detare për shumë nga qytetet dhe shtetet kryesore të Evropës mungojnë.

Infrastrukturë e dobët në destinacion

Infrastruktura në destinacionet turistike ende lë për të dëshiruar, duke filluar nga rrjetet energjetike e të ujësjellësit, e duke vazhduar me rrugët lidhëse me destinacionet, hapësirat për parkim etj.

Mungesa e zhvillimit të një oferte e përfshirë në një destinacion turistik

Përtej atraksioneve natyrore dhe atyre historike-kulturore, oferta turistike e Shqipërisë është e varfër dhe mundësitë e kombinimit të llojeve të ndryshme të turizmit janë të pakta. Ndonëse mundësitë gjenden në territor, mungesa e një oferte turistike të larmishme e gjithëpërfshirëse, që kombinon më mirë atraksionet turistike, ka kufizuar potencialin për rritjen e netqëndrimeve të turistëve, rritjen e shpenzimeve të tyre dhe shpërndarjen e ekuilibruar në territor.

Përdorimi i dobët i teknologjisë së informacionit

Përdorimi i teknologjive të informacionit në industrinë turistike është i kufizuar. Me përjashtim të ndonjë rasti sporadik, zakonisht me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, ofrimi i shërbimeve digjitale për turistët është ende i pazhvilluar. Në të njëjtin nivel është edhe përdorimi i tyre, për marketingun e shërbimeve dhe produkteve dhe shitjen në tregje.

2.4.2 Sfidat e së ardhmes

Sfidat kryesore të industrisë së turizmit për periudhën afatmesme nga kjo strategji janë identifikuar si më poshtë vijon:

Mundësimi i aksesit në destinacionet turistike, përmirësimi i infrastrukturës në destinacion dhe nxitja e zhvillimit të infrastrukturës turistike – Infrastruktura mbetet një nga elementët kyç si themeli pa të cilin industria e turizmit nuk mund të ketë as zhvillime sasiore e as cilësore. Për periudhën afatmesme, sfidë janë lidhjet e Shqipërisë me vendet e tjera, ku nevojitet shtimi i porteve e aeroporteve si edhe shpeshtimi i udhëtimeve lidhëse. Sistemi i brendshëm i transportit publik dhe aksesi në destinacionet turistike është një tjetër pikë që kërkon vëmendje. Po kaq me rëndësi është edhe infrastruktura në destinacion, e cila përfshin rrjetet elektrike e të kanalizimeve, mundësinë e parkimit etj. Së fundi, por jo për nga rëndësia, është incentivimi i infrastrukturës turistike, që nga marinat, komplekset e sporteve

ujore e dimërore, golfit, qendrat e turizmit të aventurës etj.

Rregullimi, standardizimi dhe certifikimi i strukturave akomoduese dhe shërbimeve të tjera turistike – Zbatimi i një sistemi standardizimi dhe klasifikimi të strukturave akomoduese është një element i rëndësishëm që do të garantojë nivelin e cilësisë së operatorëve dhe shërbimeve të ofruara prej tyre, si dhe do të sigurojë rregullimin e tregut të turizmit duke nxitur tërheqjen e markave ndërkombëtare të hotelerisë e operatorëve turistikë. Nisur nga zhvillimi kaotik i deritanishëm, kjo është një sfidë për të ardhmen afatmesme.

Promovimi i një produkti të integruar turistik dhe përmirësimi i imazhit të vendit – Sfida e tretë është kombinimi i atraksioneve dhe aktiviteteve turistike në produkte turistike të konsoliduara dhe promovimi i tyre në tregun rajonal, evropian e global. Ngushtësisht i lidhur me këtë element, është edhe promovimi i vendit si një destinacion turistik i sigurt e mikpritës, me një ofertë turistike të konsoliduar e me produkte autentike.

Ngritja e një sistemi eficient të formimit të vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në turizëm – Rritja e pritshme e numrit të turistëve do të ushtrojë një presion gjithnjë e në rritje mbi burimet njerëzore dhe sidomos mbi cilësinë e shërbimeve. Përballimi i masivizimit të turizmit do të jetë një sfidë e për këtë do të duhet të ngrihet një sistem efiçient i formimit profesional i cili do të mundësojë trajnime të vazhdueshme për punonjësit e strukturave akomoduese e restoranteve, për udhërrëfyesit turistikë e kështu me radhë për të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve, duke mundësuar përmirësimin e cilësisë së tyre.

3. Vizioni i Strategjisë 2019–2023

3.1 Deklarata e vizionit

"Shqipëria si një destinacion mikpritës, tërheqës, autentik për zhvillimin e potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit".

3.2 Misioni

Zhvillimi i destinacioneve, zonave, produkteve dhe diversifikimi i ofertës turistike, si dhe rritja e vlerës së shtuar të potencialeve turistike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

3.3 Synimi

Shqipëria duhet të promovohet gjerësisht në komunitetin ndërkombëtar, si një destinacion i denjë për të konkuruar barabartë në tregun global të turizmit. Rrjedhimisht pozicionimi i Shqipërisë në këtë treg do të bazohet mbi dy shtylla zhvillimi:

- *Qëndrueshmërinë afatgjatë të ndërhyrjeve dhe investimeve publike*, për ta kthyer ekonominë turistike të vendit në një atraksion për turistët, në një vend më të mirë për të jetuar, si dhe në një potencial më përfitues për sipërmarrjet në fushën e turizmit.

- *Mbrojtjen dhe zhvillimin e rregullt* të gjeohapësirave në respekt të natyrës, ekosistemeve, zhvillimit demografik dhe urban në të gjitha zonat me potencial zhvillimin e turizmit.

3.4 Qëllimet strategjike

Për realizimin e vizionit të kësaj strategjie, janë identifikuar katër qëllime strategjike, të cilat njëherazi do të jenë edhe gurët e themelit të këtij dokumenti. Bazuar në përmbushjen e çdo objektivi specifik të veçantë dhe të kombinuar, realizmin e çdo produkti të veçantë dhe të kombinuar të planifikuar në Planin e Veprimit, do të mundësohet realizimi i qëllimeve strategjike, niveli i realizimit të të cilave do të sigurohet nëpërmjet një procesi monitorimi sipas lidhjes që paraqitet në tabelën nr. 11, "Matrica e Vlerësimit të Performancës" midis çdo indikatori dhe Qëllimi Strategjik të parashikuar. Këto qëllime strategjike janë si më poshtë vijon:

1. Q.S.1 Krijimi i poleve (clusters) dhe industrive të reja të zhvillimit, si dhe konsolidimi i ofertës turistike dhe krijimi i produkteve të reja – Qëllimi ynë është që, të inkurajojmë krijimin e 6 poleve të integruara[7] me potencial turistik, që do të fokusojnë ndërhyrjet e investimeve publike, do të shtrijnë përhapjen gjeografike të destinacioneve, si dhe do të rrisin kohën e qëndrimit jo vetëm përgjatë sezonit veror, por gjatë gjithë vitit. Gjithashtu, përmes përdorimit të instrumenteve rregullatore e lehtësuese, të nxitet përmirësimi i cilësisë së strukturave akomoduese duke mbështetur rigjenerimin e atyre ekzistuese e nxitur investime të reja në struktura më 4–5 yje, të kombinohen

[7] *Aneksi 2*

aktivitetet turistike duke lëvizur drejt një oferte të konsoliduar si edhe të shtohen produktet e reja turistike si një shprehje e potencialit të pashfrytëzuar të vendit.

2. Q.S.2 Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim – Qëllimi ynë është që, përmes prioritizimit të investimeve publike, nxitjes së investimeve private, tërheqjes së një numri më të madh të turistëve dhe rritjes së kohëqëndrimit të tyre në vend, industria e turizmit të kthehet në një nga tre shtyllat kryesore të ekonomisë shqiptare e një nga burimet më të sigurta të vendeve të reja të punës.

3. Q.S.3 Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i cilësisë së tyre – Qëllimi ynë është që, përmes ndërhyrjeve rregulluese, lehtësuese e përkrahëse, të standardizohen e certifikohen ofruesit e shërbimeve turistike, si edhe të mbështetet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të tjera, përmes ngritjes së një sistemi të formimit të vazhdueshëm profesional për gjithë burimet njerëzore në industrinë e turizmit.

4. Q.S.4 Përmirësimi i imazhit të vendit dhe promovimi i produkteve autentike lokale Qëllimi ynë është që, përmes një fushate të zgjuar marketing, të promovojmë pasuritë natyrore, historike e kulturore të Shqipërisë, duke përmirësuar imazhin ndërkombëtar të vendit e duke tërhequr më shumë vizitorë.

4. Objektivat e politikës dhe objektivat specifikë

Për realizimin e qëllimeve strategjike të sipër-përmendura, do të punohet në pesë objektiva të politikës. Për secilin objektiv politik janë përcaktuar nga tre objektiva specifikë që të aplikuara bashkërisht, do të çojnë në realizimin e secilit objektiv. Pesë objektivat e politikës janë si vijon:

- Objektivi politik 1: Nxitja e investimeve publike dhe private;
- Objektivi politik 2: Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike;
- Objektivi politik 3: Përmirësimi i shërbimeve turistike;
- Objektivi Politik 4: Riorientimi i promovimit drejt potencialeve;
- Objektivi politik 5: Mbështetje për menaxhimin e destinacioneve.

4.1 Objektivi politik 1: Nxitja e investimeve publike dhe private

Objektivi 1.1 Nxitja e investimeve strategjike private, si dhe tërheqja e markave të mirënjohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm

Zhvillimi cilësor i industrisë së turizmit është i lidhur ngushtësisht me tërheqjen në vendin tonë të operatorëve të njohur ndërkombëtare të hotelerisë dhe turizmit. Zbatimi i një programi që do të promovojë lehtësirat fiskale të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe bashkëpunimi i mëtejshëm për të mbështetur e lehtësuar këta investitorë strategjikë, është një prioritet kyç i kësaj strategjie.

Objektivi 1.2 Përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe orientimi i investimeve private drejt tyre

- Për një zhvillim të qëndrueshëm e të mirëplanifikuar, investimet publike dhe private duhet të orientohen drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit. Në zbatim të Planit Kombëtar Sektorial për Fushën e Turizmit, do të hartohen planet e detajuara të zhvillimit për secilën nga këto zona dhe do të hartohen politika specifike për nxitjen e investimeve private në to.

Objektivi 1.3 Orientimi i investimeve publike drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike për përmirësimin e infrastrukturës bazë në to.

Një nga problemet më të mprehta të zhvillimit të turizmit në vendin tonë është infrastruktura lidhëse dhe infrastruktura e dobët në destinacion. Nevojitet që, nga njëra anë, të përmirësohet rrjeti i përgjithshëm i transportit në vend dhe, nga ana tjetër, të investohet në infrastrukturën bazë në destinacion si rrjeti elektrik, rrjeti i ujësjellës-kanalizimeve, hapësirat e parkimit, shëtitoret, informacioni turistik etj.

4.2 Objektivi politik 2: Përmirësimi i shërbimeve turistike

Objektivi 2.1 Zhvillimi i modeleve të reja të vlerësimit, standardizimi, certifikimi dhe klasifikimi i shërbimeve në funksion të turizmit dhe operatorëve turistikë.

- Rritja e cilësisë së shërbimeve turistike është ngushtësisht e lidhur me standardizimin e këtyre shërbimeve dhe certifikimin e ofertuesve të tyre. Deri në vitin 2023, do të konsolidohen standardet, do të klasifikohen strukturat

akomoduese dhe do të ngrihet një regjistër i tyre, i cili do të përditësohet vazhdimisht.

Objektivi 2.2 Krijimi i Kuadrit Rregullator dhe Institucional për zhvillimin e arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimi i burimeve njerëzore të angazhuara në sektor.

Përmirësimi i shërbimeve lidhet edhe me burimet njerëzore. Objektivi i kësaj strategjie është që të hartohet korniza e kualifikimeve e të punohet mbi kurrikulat në mënyrë që më pas të procedohet me trajnimin e gjithë profesioneve të lidhura me turizmin si edhe të banorëve të zonave turistike.

Objektivi 2.3 Hartimi i kuadrit rregullator dhe institucional për zhvillimin e shërbimeve dhe mënyrën e operimit të porteve turistike dhe aktiviteteve në funksion të tyre.

Një mundësi tjetër zhvillimi që ofron bregdeti shqiptar është dhe ai i turizmit detar. Shqipëria ka potenciale të pashfrytëzuara, me një numër të konsiderueshëm gjiresh të virgjëra që shtrihen përgjatë vijës bregdetare për krijimin e porteve turistike/marinave. Oferta për këtë lloj turizmi duhet të drejtohet drejt kruazierave të mëdha, jahteve dhe udhëtimeve të shërbimeve *charter* me cilësi të lartë. Është e nevojshme paraprakisht të përgatitet kuadri i nevojshëm rregullator që lehtëson zhvillimin e këtij segmenti.

4.3 Objektivi politik 3: Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike

Objektivi 3.1 Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar dhe krijimi i produkteve të reja

- Industria e turizmit në Shqipëri varet në një pjesë të madhe nga deti dhe llojet e turizmit të lidhura me të. Por, ndërkohë që plazhi dhe aktivitetet e tjera bregdetare kanë pasur zhvillime pozitive vitet e fundit, lloje të tjera si turizmi detar janë ende potenciale të pashfrytëzuara. Është me rëndësi që oferta aktuale të konsolidohet edhe më tej dhe, njëkohësisht, të punohet për shtimin e produkteve të reja duke nxitur investimet në ndërtimin e porteve e marinave, si edhe në infrastrukturën mbështetëse të turizmit detar.

Objektivi 3.2 Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi i produkteve të reja.

- Kategoria e turizmit natyror dhe të gjitha llojet e aktiviteteve që përfshihen këtu janë një nga potencialet ende të pashfrytëzuara aq sa duhet në vendin tonë, ndonëse zhvillimet pozitive nuk kanë munguar. Në të ardhmen do të duhet të punohet për krijimin e produkteve të reja në këtë drejtim, si identifikimi dhe shënjimi i shtigjeve të ecjes apo çiklizmit, zhvillimi i turizmit dimëror, ngritja e qendrave turistike në zonat e mbrojtura natyrore, zhvillimi i mëtejshëm i turizmit rural etj.

Objektivi 3.3 Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik dhe krijimi i produkteve të reja.

- Kategoria e turizmit tematik përbëhet nga disa lloje të turizmit të cilat plotësojnë dhe kompletojnë ofertën turistike të Shqipërisë. Në kuadër të turizmit kulturor, do të hartohet një plan veprimi, do të investohet në identifikimin e itinerareve historike e kulturore e do të organizohen veprimtari ndërkombëtare. Gjithashtu, parashikohen të merren masa edhe për zhvillimin e turizmit shëndetësor dhe atij të biznesit.

4.4 Objektivi politik 4: Riorientimi i promovimit drejt potencialeve turistike

Objektivi 4.1 Hartimi i Strategjisë së Brandit dhe Marketingut të Turizmit

- Prej kohësh ka lindur nevoja e një Strategjie të re të Brandit dhe Marketingut të Turizmit Shqiptar. Strategjia e Brandit do të ketë fokus produktet autentike shqiptare, si dhe krijimin e miteve, historive, atraksioneve të ndryshme, që do t'u shërbejnë organizatave promovuese për të modeluar një "fabul" për Shqipërinë turistike. Ndërkohë përmes Strategjisë së Marketingut do të evidentohen target grupet dhe llojet e turistëve që do të duhet të njihen me potencialet e Shqipërisë.

Objektivi 4.2 Promovimi i produkteve turistike gjithëvjetore brenda dhe jashtë vendit.

- Produktet (ose oferta turistike) e Shqipërisë mund të jenë tepër të larmishme duke filluar që nga destinacionet, vlerat historike dhe kulturore e deri te prodhimet artizanale, ushqimet, pijet etj. Këto produkte do të promovohen vazhdimisht, jo vetëm përgjatë sezonit veror, duke synuar njëkohësisht edhe audienca specifike. Do të synohet ngritja e një strukture pranë përfaqësive tona diplomatike si edhe përdorimi sa më efektiv i kanaleve të tjera të promovimit.

Objektivi 4.3 Mbështetja e agjentëve promovues të vendit në Shqipëri dhe diasporë

- Konsideruar se strategjia e zhvillimit dhe promovimit të turizmit është përgjegjësi ndërinstitucionale dhe jo vetëm objekt i një

institucioni të vetëm, do të synohet drejt inkurajimit të mekanizmave alternativë të promovimit, qoftë këto Agjentë apo Agjenci Turistike që do të angazhohen në promovimin e Shqipërisë drejt një territori të caktuar jashtë Shqipërisë, e duke vijuar edhe me zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit si një mjet për promovimin e destinacioneve dhe informimin e vizitorëve. Për këtë qëllim, do të ngrihet një portal informues mbi agjentët e promovimit, destinacionet dhe produktet turistike që mund të zhvillohen në Shqipëri.

4.5 Objektivi politik 5: Mbështetje për menaxhimin e destinacioneve

Objektivi 5.1 Zhvillimi i modelit të menaxhimit të destinacioneve

- Zhvillimi dhe menaxhimi i destinacionit është drejtimi strategjik drejt të cilit do synohet të shtyhet industria e turizmit në vend. Objektiv kyç i kësaj strategjie është ngritja e një organizate menaxhimi për secilin destinacion dhe zhvillimi i produkteve specifike për secilin prej tyre, duke bërë të mundur që destinacionet të zhvillohen duke ruajtur autenticitetin e tyre.

Objektivi 5.2. Konsolidimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin dhe operimin e organizatave të menaxhimit të destinacioneve

- Menaxhimi efektiv dhe i përhershëm i destinacioneve turistike kërkon një harmonizim të të gjitha instrumentave ligjore e politikë-bërëse në vend. Në përputhje me këtë strategji, do të amendohen akte nënligjore ekzistuese, do të hartohen akte të tjera, si edhe do të punohet për instrumentat e planifikimit. Si strukturë menaxhimi, me prioritet do të shihet ngritja dhe vendosja në funksionim e degëve territoriale të turizmit.

Objektivi 5.3 Monitorimi dhe mbështetja e organizatave të menaxhimit të destinacioneve

- Në momentin e krijimit, OMD do të kenë nevojë për monitorim të vazhdueshëm, koordinim të veprimtarive sidomos me organizatat lokale dhe donatorët, si dhe zhvillimin e programeve të ndryshëm të asistencës dhe të ndihmës shtetërore, për promovimin e zhvillimin e tyre. Qëllimi është mbështetja e OMD deri në momentin që do të jenë të pavarura, sidomos në aspektin financiar, me qëllim realizimin e misionit të tyre me sukses.

4.6 Outputet ekonomike

Realizimi i objektivave të kësaj strategjie në pesë drejtimet kryesore të sipërpërmendura do të ketë një efekt të drejtpërdrejtë mbi ekonominë e vendit. Gjithashtu, kjo strategji duke marrë në konsideratë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në kuadër të Agjendës për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në shtator 2015, synon të adresojë çështjet sa i përkasin reduktimit të varfërisë, rritjes së mirëqenies, rritjes ekonomike, edukimit, barazisë gjinore, zhvillimit lokal etj.

Nëse të gjitha objektivat do të përmbushen siç është parashikuar, rezultati i matshëm mbi ekonominë shqiptare do të jetë si më poshtë vijon:

Outputi 1. Rritja e kontributit të drejtpërdrejtë të turizmit në PBB nga 8.4% më 2016 në 10% më 2023 dhe e kontributit total nga 26% më 2016 në 29% më 2023 (OZHQ.1, 8).

Outputi 2. Rritja e të ardhurave nga turizmi hyrës (*incoming*) nga 1,7 miliardë euro në 2017, në 2 miliardë euro në 2023 (OZHQ.1)

Outputi 3. Tërheqja e 2,552 milionë euro investime të huaja direkte në turizëm deri në vitin 2023 (OZHQ.8, 9, 11)

Outputi 4. Rritja e numrit të të punësuarve drejtpërdrejt në sektorin e turizmit nga 85,000 në vitin 2016 në 100,000 në vitin 2023 dhe rritja e numrit të të punësuarve në total në këtë sektor nga 267,000 në 2016 në 300,000 më 2023 (OZHQ 1, 4, 5, 11).

Outputi 5. Nxitja dhe mbështetja për krijimin e 6,000 bizneseve të reja në fushën e turizmit deri në 2023 (OZHQ 4, 5, 8, 12).

Outputi 6. Rritja e vazhdueshme e investimeve publike në turizëm duke arritur në 6,3% të investimeve publike më 2023 (OZHQ 9, 11)

Outputi 7. Rritja e të ardhurave direkte nga taksat nga sektori i turizmit me 9 miliardë lekë deri në vitin 2023 dhe rritja e të ardhurave totale nga taksat nga sektori i turizmit me 31 miliardë lekë deri në vitin 2023. (OZHQ 11)

5. Burimet financiare

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit është shumë dimensionale dhe përfshin një sërë sektorësh, nënsektorësh e politikash. Ky kapitull ka për qëllim qartësimin e burimeve specifike në varësi të objektivave, politikave e qëllimeve strategjike.

Duke qenë të vetëdijshëm lidhur me kufizimet e buxhetit të shtetit dhe vështirësitë financiare që e karakterizojnë atë, gjatë buxhetimit të strategjisë

janë marrë në konsideratë edhe financime nga donatorët në formën e granteve apo kredive, si edhe të gjitha llojet e tjera të financimeve të parashikuara kapitale, operacionale dhe të asistencës teknike.

Ashtu si çdo strategji, edhe Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit ndikon në shpërndarjen e shpenzimeve publike prandaj duhet mbajtur parasysh roli i saj si një dokument reference që udhëheq planet buxhetore të viteve të ardhshme të Qeverisë. Ashtu siç parashikohet edhe nga urdhri i Kryeministrit nr. 93, datë 7.8.2012 i cili përcakton metodologjinë për hartimin e strategjive sektoriale, Projekt-Buxheti Afatmesëm (PBA) është elementi thelbësor i Sistemit të Integruar të Planifikimit (SIP) e rrjedhimisht, është edhe instrumenti kryesor për bashkërendimin e buxhetit me politikat dhe objektivat strategjikë të Qeverisë.

Parashikimet e PBA 2019–2021 për programin "Zhvillimi i Turizmit" gjenden në tabelën e mëposhtme. Programi "Zhvillimi i Turizmit" përfshin buxhetin e parashikuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (pjesa për turizmin), Agjencinë Kombëtare të Turizmit, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (pjesa e turizmit).

Duke parë kufizimet buxhetore, duhet të synohet një përdorim më eficient i çdo burimi financimi duke u përqendruar në politikat dhe projektet të cilat kanë një efekt multiplikativ më të lartë dhe që mund të gjenerojnë të ardhura në një periudhë më të afërt kohore në ekonomi, duke plotësuar më mirë objektivat strategjike për turizmin.

Tabela 9. Parashikimet për 2019–2023 për programin e zhvillimit të turizmit

Viti	Shuma
2019	198,746,000*
2020	372,700,000
2021	372,700,000
2022-23	480,000,000
Total	**1,424,146,000**

Burimi: PBA 2019-2021 dhe parashikim

**Sqarojmë së për vitin 2019 buxhetimi i aktiviteteve është vetëm për pjesën e mbetur të vitit*

Duke u bazuar në normën e pritshme të rritjes ekonomike, është bërë i mundur një projeksion i buxhetit të pritshëm të turizmit edhe për periudhën që nuk mbulohet nga PBA 2019–2021.

Nga ana tjetër, janë një sërë institucionesh të tjera, qëndrore e lokale, veprimtaria dhe buxhetet e të cilave kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi sektorin e turizmit dhe realizimin e objektivave strategjikë të kësaj strategjie.

Në përllogaritjen e kostos së Strategjisë janë parashikuar, përveç Buxhetit të Shtetit, edhe financime nga Bashkimi Evropian dhe donatorët e ndryshëm. Pjesa e donatorëve është trajtuar duke ruajtur të dhënat reale të disponueshme.

Një analizë më e detajuar sipas drejtimeve strategjike dhe fushave kryesore është e pasqyruar edhe në planin e veprimit bashkangjitur këtij dokumenti që në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën 10, më poshtë:

Tabela 10. Buxheti i përgjithshëm i planit të veprimit të strategjisë

Objektivi i politikës (OP)	Kosto totale (lek '000)	Mbulimi nga buxheti dhe donatorët	Hendeku financiar
TOTALI	**1,829,840**	**1,645,619**	**184,220**
O.P.1 Nxitje e investimeve publike dhe private	252,490	223,290	29,200
O.P.2 Përmirësimi i shërbimeve turistike	545,060	509,460	35,600
O.P.3 Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike	219,450	130,750	88,700
O.P.4 Riorientim i promovimit drejt potencialeve	704,200	452,006	30,720
O.P.5 Mbështetje për menaxhimin e destinacioneve	108,640	108,640	0

Për zbatimin e suksesshëm të strategjisë nevojitet domosdoshmërish një koordinim i veprimtarive të ministrive të linjës e institucioneve të tjera, si edhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë donatorët në këtë fushë në mënyrë që agjenda e tyre të jetë në përputhje me këtë strategji.

6. Zbatimi dhe monitorimi

Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi janë thelbësore në zbatimin efektiv të strategjisë.

Monitorimi i realizimit të katër qëllimeve strategjike përmes treguesve qartësisht të përcaktuar do të ofrojë një bazë solide për zbatimin dhe monitorimin e progresit në këtë drejtim.

Mjeti kryesor monitorues do të jetë Matrica për Vlerësimin e Perfomancës e cila do të ofrojë një panoramë të qartë të progresit të arritur në realizimin e secilit qëllim strategjik, matur përmes indikatorëve të matshëm. Kjo matricë do të përfshijë vlerën bazë, etapat vjetore, qëllimin final dhe mënyrën e verifikimit.

Identifikimi i treguesve dhe përcaktimi i përgjegjësive është bazuar në kapitullin mbi qëllimet strategjike, kapitullin mbi objektivat dhe planin e veprimit. Si institucioni përgjegjës për turizmin, MTM-ja do të kryejë koordinimin e përgjithshëm të procesit të monitorimit, do të vlerësojë progresin, si edhe do të japë rekomandime e paraqesë amendamente të mundshme për ndryshime.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të zbatohet në përputhje me procesin e raportimit të SKZHI 2015–2020 dhe kalendarin e Sistemit të Planifikimit të Integruar. Zbatimi i strategjisë deri në vitin 2023 do të jetë një proces dinamik që do të kërkojë përditësime të rregullta për të bërë të mundur që strategjia të jetë në përputhje me ndryshimet e mundshme në politikat, iniciativat dhe prioritetet e qeverisë.

Për shkak të natyrës heterogjene të sektorit të turizmit dhe lidhjes me shumë sektorë të tjerë, për të siguruar bashkëveprimin dhe vendimmarrjen e përbashkët në nivel të lartë politik dhe menaxherial për planifikimin, bashkërendimin e ekzekutimin dhe monitorimin e politikave të programit, propozohet që procesi i zbatimit dhe monitorimit të ndiqet nga Grupi Tematik për Zhvillimin e Turizmit dhe Kulturës dhe prefektët e qarqeve, kryesuar nga zëvendësministri pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përgjegjës për sektorin, sipas urdhrit të Kryeministrit, nr. 157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

Ndërkohë, në cilësinë e anëtarëve vëzhgues, janë edhe (nga një) përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, Shoqatës Vendore, Shoqata e Këshillave të Qarqeve, Shoqata për Autonomi Vendore, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe një përfaqësuesi të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, shoqatat e operatorëve turistikë, shoqatat e skenës së pavarur kulturore, universitetet, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëria civile dhe komunitetet lokale.

Grupi takohet së paku dy herë në vit, ndërsa objektivi kryesor i punës së tij është diskutimi dhe aprovimi i planit vjetor të veprimit, raportit vjetor për zbatimin e Strategjisë së Turizmit 2019–2023 dhe monitorimi i realizimit të aktiviteteve. Pranë këtij grupi, funksionon Sekretaria teknike me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, të cilët caktohen me urdhër të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Bazuar në raportimet e raportet e realizimit të aktiviteteve, Sekretaria Teknike do të përgatitë Raportin Vjetor të realizimit të aktiviteteve dhe vlerësimit të indikatorëve.

Raporti i cili i paraqitet Grupit, do të bazohet në analizën e treguesve të tre llojeve:

a) treguesit e referencës, të cilët sigurojnë informacion mbi gjendjen në kohën e përgatitjes së strategjisë;

b) treguesit e *output*-it që do të matin rezultatet e prekshme të aktiviteteve të zbatuara;

c) treguesit e performancës që do të matin progresin e kryer deri në arritjen e qëllimit final.

Të dhënat që i shërbejnë monitorimit do të grumbullohen në një bazë të dhënash që do të mbahet e përditësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit. Kjo drejtori do të jetë përgjegjëse për kryerjen e kërkesave për të dhëna në drejtoritë e tjera brenda ministrisë apo në institucionet e tjera.

Të dhënat e mbledhura do të administrohen sipas aneksit nr. 3, pasaporta e indikatorëve, bashkëlidhur kësaj strategjie.

Tabela 10. Matrica e vlerësimit të performancës

Nr.	Përshkrimi i treguesve	Njësia (% /nr)	Institucioni përgjegjës	Lidhja me Qëllimet Strategjike	Viti bazë 2017	Viti bazë 2018	Synimi 2019	Synimi 2020	Synimi 2021	Synimi 2022	Synimi 2023
Outputet ekonomike											
1	Rritja e kontributit direkt të turizmit në PBB	%	MTM	Q.S.2	8.7%	8.9%	9.3%	9.5%	9.8%	10%	11%
2	Rritja e kontributit total të turizmit në PBB	%	MTM	Q.S.1.2.3	26.7%	27.1%	27.4%	27.9%	28.5%	29%	29.5%
3	Rritja e punësimit direkt nga turizmi	%	MTM & INSTAT	Q.S.2.3	7.8%	7.9%	8.1%	8.2%	8.3%	8.5%	9%
4	Rritja e punësimit total nga turizmi	%	MTM & INSTAT	Q.S.1.2	24.2%	24.4%	24.7%	25.1%	25.5%	26%	27%
5	Rritja e të ardhurave direkte nga taksat dhe tatimet në nivel vendi	Në miliard lekë	MFE	Q.S.2.3	23.0	24.2	25.4	26.6	27.8	29.3	31
6	Rritja e të ardhurave totale nga taksat dhe tatimet në nivel vendi	Në miliard lekë	MFE	Q.S.4	80.7	84.6	88.7	93.0	97.1	102.3	107
7	Rritja e të ardhurave nga udhëtimi/turizmi (Euro)	Në milion euro	BSH	Q.S.2.3	1,707	1,856	2,042	2,225	2,403	2,620	2,829
8	Krijimi i bizneseve apo sipërmarrjeve të reja në sektorin e turizmit	%	QKB	Q.S.1	5.3%	5.0%	4.8%	4.6%	4.4%	4.2%	4.2 %
Objektivi i politikës : Nxitja e investimeve publike dhe private											
9	Rritja e investimeve në sektorin e turizmit në raport me investimet publike	%	MFE	Q.S.1	5.9%	5.9%	6.0%	6.1%	6.2%	6.3%	6%
10	Rritja e investimeve të huaja direkte të lidhura në mënyrë indirekte në sektorin e turizmit	Në milion euro	MTM	Q.S.1.2.3	2,084	2,178	2,271	2,365	2,459	2,552	2,600
11	Rritja e investimeve private	Në milion lekë	MTM	Q.S.1.2.3	22,771	23,909	25,105	26,36	27,678	29,062	31,000

Objektivi i politikës : Përmirësimi i shërbimeve turistike											
12	Rritja (%) e të punësuarve të kualifikuar/certifikuar	%	MFE	Q.S.3	15.2%	16.6%	17.8%	19.0%	20.0%	21.0%	22.0%
13	Trajnimi i 50% të të punësuarve në sektorin e turizmit deri në vitin 2022	%	MTM, MFE	Q.S.3		10%	10%	10%	10%	10%	10%
14	Përmirësimi i standardeve dhe cilësisë në strukturat akomoduese. Klasifikimi i strukturave akomoduese	Numër	MTM	Q.S.3			325	325	525	525	525
15	Regjistrimi i 80% të strukturave akomoduese të vogla e familjare	%	MTM	Q.S.2.4			20%	20%	20%	20%	20%
16	Numri i udhërrëfyesve turistikë të certifikuar	Numër	MTM	Q.S.3	240	60	50	40	40	70	40
Objektivi i politikës : Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike											
17	Numri i shtretërve sipas llojit të strukturës akomoduese	Numër	MTM, INSTAT	Q.S.1.3	75,050	79,553	84,326	89,385	94,749	100,433	106,400
18	Ndërtimi i 7 resorteve që ofrojnë shërbime komplekse	Numer	MTM	Q.S.1.2			2	1	1	1	2
19	Ndërtimi i porteve të reja të përshtatshme për marina dhe stacione portuale të vogla për transport të brendshëm detar	Numër	MTM, MIE	Q.S.1.2	1	1	1	1	1	1	1
20	Ndërtimi i marinave për të nxitur dhe ndihmuar zhvillimin e turizmit elitar	Numër	MTM	Q.S.1.2				1	1	1	2
21	Ndërtimi i tre shtigjeve rajonale dhe dy shtigjeve kombëtare të çiklizmit	Numër	MTM	Q.S.3.4				1	1	2	1
22	Identifikimi dhe zhvillimi i pesë vendndodhjeve për zhvillimin e alpinizmit	Numër	MTM	Q.S.3.4				1	1	2	1
23	Identifikimi dhe zhvillimi i tre itinerareve të lundrimit me trap	Numër	MTM	Q.S.3.4				1	1	1	
24	Identifikimi, shënjimi dhe dixhitalizimi i pesë shtigjeve të reja rajonale dhe dy shtigjeve ndërkufitare të ecjes	Numër	MTM	Q.S.3.4				1	2	1	1
25	Zhvillimi i shtatë itenerareve historike e kulturore	Numër	MTM MK	Q.S.3.4			1	2	2	1	1

26	Ndërtimi në destinacione kryesore turistike, në varësi edhe të kapaciteteve akomoduese, të qendrave multifunksionale konferencash dhe kongresesh	Numër	MTM	Q.S.1.2					1		1
27	Rritja e të ardhurave të gjeneruara nga institucionet dhe objektet e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore	%	MK	Q.S.2	0,25	0,25	0,25	0,25	0,3	0,3	0.3
28	Rritja e numrit të vizitorëve në institucionet dhe qendrat e vizitueshme të trashëgimisë kulturore kombëtare	Numër	MK	Q.S.1	669,110	998,441	1,098,000	1,262,700	1,452,105	1,597,315	1,757,000
Objektivi i politikës : Riorientim i promovimit drejt potencialeve turistike											
29	Rritja e netqëndrimeve në të gjithë llojet e strukturave akomoduese	Numër	MTM	Q.S.2	25,277,668	26,541,551	27,868,629	29,262,060	Mbi 30 milionë		
30	Pjesëmarrje në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare	Numër	MTM, AKT	Q.S.4	18	18	20	20	22	24	28
31	Rritja e numrit të vizitorëve të huaj (turizmi në hyrje)	Numër	MTM	Q.S.2	5.117.700	5,927,000	6,401,160	6,913,253	Mbi 7 milionë		
Objektivi i politikës : Mbështetje për menaxhimin e destinacioneve											
32	Organizata e Menaxhimit të Destinacionit e ngritur	Akt	MTM	Q.S.4							
33	Sistemi i ri i statistikave të turizmit i ngritur	Akt	MTM	Q.S.3							

Aneksi 2



Zonat me përparësi zhvillimin e turizmit



Polet e zhvillimit të turizmit (Clusters)

Kodi	Objektivi Politik	Objektivi specifik	Produkti	Institucionet përgjegjëse	Afati realizimit	Kosto totale (000 lekë)	Financim i brendshëm (000 lekë)				Programi buxhetor i financimit	Financim i huaj (000 lekë)	Hendeku (000 lekë)	Komente për objektivat me hendek financiar
							Totali 2019-2023	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021				
1						**252,490.00**	**223,290.00**	**30,476.60**	**59,535.40**	**57,535.40**		**0.00**	**29,200.00**	
1.1		**Nxitja e investimeve strategjike private, si dhe tërheqja e markave të mirënjohura ndërkombëtare në hoteleri dhe turizëm**	Konferencave periodike për tërheqjen e investitorëve	**MTM, MFE, AIDA**	**2019-2023**	20,000.00	15,000.00	2,100.00	3,900.00	3,900.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	5,000.00	Janë parashikuar 8 konferenca për të cilat buxheti në dispozicion mbulon vetëm katër.
			Lehtësira për investimet strategjike në turizëm	**MTM, MFE, AIDA**	**2019-2023**	6,000.00	5,000.00	700.00	1,300.00	1,300.00		0.00	1,000.00	Paketë fiskale për tërheqjen e investitorëve.
			Norma kreditimi preferenciale për investimet e mëdha në turizëm	**MTM, MFE**	**2019-2023**	110.00	110.00	15.40	28.60	28.60		0.00	0.00	
			Kuadër ligjor miqësor me biznesin për të përshpejtuar zhvillimin e sektorit	**MTM**	**2020**	2,000.00	2,000.00	0.00	2,000.00	0.00		0.00	0.00	
1.2	**Nxitje e Investimeve Publike dhe Private**	**Përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe orientimi i investimeve private drejt tyre**	Plane të detajuara të zhvillimit dhe veprimit për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit në zbatim të Planit Kombëtar Sektorial për Fushën e Turizmit	**MTM, AKPT, AZHT,**	**2019-2023**	3,000.00	2,000.00	28.00	520.00	520.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	1,000.00	Nevojitet më shumë buxhet për të qenë më prezent në terren gjatë hartimit të planeve.
			Modele të zhvillimit ekonomik për nën-zonat e përcaktuara në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.	**MTM, AKPT, AZHT,**	**2019-2023**	2,000.00	2,000.00	28.00	520.00	520.00		0.00	0.00	Nevojitet më shumë buxhet për të qenë më prezent në terren gjatë hartimit të planeve.
			Katalogë informues për zonat në zhvillim ku do të përfshihet informacion mbi pronësinë, lehtësirat fiskale, taksimin, koston e punës, tregun e mundshëm etj.	**MTM**	**2019-2023**	25,000.00	25,000.00	3,500.00	6,500.00	6,500.00		0.00	0.00	Është parashikuar botimi në formate të ndryshme i materialeve informuese dhe promovuese.
			Kuadër ligjor mbështetës, me incentiva fiskale dhe administrative, për ndërtimin e resorteve dhe hoteleve me 4 e 5 yje në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.	**MTM**	**2019-2023**	50,000.00	50,000.00	7,000.00	13,000.00	13,000.00		0.00	0.00	
1.3.		**Orientimi i investimeve publike drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike për përmirësimin e infrastrukturës bazë në to**	Akses i përmirësuar drejt destinacioneve turistike.	**MTM, MIE, MFE, MSHMS**	**2019-2022**	240.00	240.00	33.60	62.40	62.40	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
			Sinjalistikë e plotë rrugore e turistike në çdo destinacion turistik.	**MIE, MTM, NJ.V.V**	**2019-2023**	130,000.00	110,800.00	15,512.00	28,808.00	28,808.00		0.00	19,200.00	Nevojë e lartë për plotësimin e sinjalistikës.
			Hapësira parkimi dhe transport publik në çdo destinacion turistik.	**MIE, NJ. V.V, MTM**	**2019-2023**	600.00	600.00	84.00	156.00	156.00		0.00	0.00	
			Sistem informacioni turistik i përmirësuar në plazhe dhe zona turistike.	**MTM, NJ.V.V**	**2019-2023**	13,000.00	10,000.00	1,400.00	2,600.00	2,600.00		0.00	3,000.00	Nevojë e lartë për plotësimin e sinjalistikës informuese në plazhe.
			Furnizim pa ndërprerje me energji elektrike dhe ujë në	**MIE, NJ.V.V,**	**2019-2023**	300.00	300.00	42.00	78.00	78.00		0.00	0.00	

			destinacionet turistike.	**MTM**										
			Qendra shëndetësore në çdo destinacion turistik.	**MSHMS, MTM**	**2019-2023**	240.00	240.00	33.60	62.40	62.40		0.00	0.00	
2						**545,060.00**	**509,460.00**	**57,857.80**	**104,290.20**	**153,580.20**		**0.00**	**35,600.00**	
2.1	**Përmirësimi i Shërbimeve Turistike**	**Formalizim, standardizim dhe mbështetje për veprimtaritë turistike**	2,000 strukturave akomoduese të klasifikuara deri në vitin 2023	**MTM**	**2019-2023**	9,000.00	9,000.00	1,260.00	2,340.00	2,340.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
			Studim mbi inventarin e apartamenteve, vilave dhe shtëpive private që përdoren për aktivitet turistike dhe formalizimin e tyre	**MTM**	**2019**	5,000.00	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00		0.00	0.00	
			Kuadër ligjor mbi kriteret minimale të operimit si strukturë akomoduese për apartamentet, vilat dhe shtëpitë private	**MTM**	**2019-2020**	800.00	800.00	250.00	550.00	0.00		0.00	0.00	
			Skemë e certifikimit "eco" për strukturat akomoduese.	**MTM**	**2019-2023**	1,000.00	800.00	112.00	208.00	208.00		0.00	200.00	Ngritja e skemës "eco" si nevojë për orientimin e bizneseve drejt mbrojtjes së mjedisit.
			Struktura pritëse cilësore në fshatrat tradicionale	**MTM**	**2019-2023**	370,000.00	350,000.00	38,119.00	75,166.00	91,000.00		0.00	20,000.00	Mbështetje me qëllim rritjen e cilësisë në kapacitetet pritëse në zonat rurale.
			Regjistër i përditësuar i strukturave akomoduese	**MTM**	**2019-2023**	10,000.00	10,000.00	1,400.00	2,600.00	2,600.00		0.00	0.00	
			Rregulla dhe standarde për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve turistikë, agjencive të udhëtimit dhe udhërrëfyesve turistikë	**MTM**	**2019-2023**	200.00	200.00	28.00	52.00	52.00		0.00	0.00	
			Inspektime për respektimin e standardeve në subjektet turistike	**MTM**	**2019-2023**	60,000.00	60,000.00	5,400.00	11,600.00	25,600.00		0.00	0.00	
			Treg turistik i formalizuar.	**MTM**	**2019-2023**	50,000.00	50,000.00	5,000.00	9,000.00	25,411.00		0.00	0.00	
2.2		**"Zhvillimi i Burimeve njerëzore të angazhuara në sektorin e turizmit"**	Akreditimi i institucioneve që ofrojnë arsim e formim profesional në fushën e turizmit	**MTM, MFE**	**2019-2023**	70.00	70.00	9.80	18.20	18.20	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
			Plan vjetor trajnimi për zhvillimin e burimeve njerëzore në bazë të nevojave të evidentuara të tregut	**MTM, MFE**	**2019-2020**	5,000.00	300.00	100.00	200.00	0.00		0.00	4,700.00	Edukimi në vazhdim i stafit operues në të gjithë vendin është faktor kryesor në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.
			Hapja e degëve të institucioneve të njohura ndërkombëtare në fushën e arsimit mbi turizmin	**MTM, MFE**	**2020-2021**	7,000.00	1,000.00	0.00	500.00	500.00		0.00	6,000.00	Eksperienca që sjellin institucionet edukuese ndërkombëtare do të mundësojë shërbime konkurruese në rajon.
			Përfshirja e njohurive të turizmit në kurrikulën arsimore 9-vjeçare	**MTM, MAS**	**2020-2021**	250.00	250.00	0.00	125.00	125.00		0.00	0.00	
			Evidentimi i nevojave, nxitja dhe mbështetja e trajnimeve për të punësuarit në nivelin	**MTM, MFE**	**2019-2023**	20,000.00	20,000.00	800.00	1,200.00	5,200.00		0.00	0.00	

			menaxherial dhe të shërbimeve të të punësuarve në sektorin e turizmit											
			Punonjës të kualifikuar sipas fushës së operimit, me fokus të veçantë te gratë dhe të rinjtë, në sektorin e turizmit.	**MTM, MFE**	**2019-2023**	500.00	500.00	70.00	130.00	130.00		0.00	0.00	
			Trajnim i vazhdueshëm i banorëve të zonave turistike mbi mënyrat e ofrimit të shërbimit	**MTM, MFE**	**2019-2023**	350.00	350.00	49.00	91.00	91.00		0.00	0.00	
2.3		**Hartimi i kuadrit rregullator dhe institucional për zhvillimin e shërbimeve dhe mënyrën e operimit të Porteve Turistike dhe aktiviteteve në funksion të tyre**	Kuadër ligjor "Për turizmin detar" dhe "Mbi normat e lundrimit me mjete lundruese turistike"	**MTM**	**2019-2020**	5,000.00	300.00	95.00	205.00	0.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"; Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrimi" i MTM-së	0.00	4,700.00	Zhvillimi i marinave është një nga katër polet e programit të zhvillimit të turizmit që aktualisht është në hapat e parë.
			Plan i masave për marinat lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe respektimin e standardeve mjedisore	**MTM**	**2019-2022**	250.00	250.00	35.00	70.00	70.00		0.00	0.00	
			Kalimi në përdorim civil, në shërbim të turizmit, i porteve ekzistuese ushtarake	**MTM**	**2019-2021**	400.00	400.00	100.00	150.00	150.00		0.00	0.00	
			Stimulimi i ardhjes në Shqipëri të kruazierave të vogla	**MTM**	**2019-2022**	240.00	240.00	30.00	85.00	85.00		0.00	0.00	
3	**Konsolidimi dhe zhvillimi i produkteve turistike**					**219,450.00**	**130,750.00**	**40,154.00**	**59,816.00**	**10,286.00**		**0.00**	**88,700.00**	
3.1		**Zhvillimi i Programit të Turizmit Bregdetar e Detar dhe krijimi i produkteve të reja**	Ngritja e sistemit të certifikimit "Blue Flag" në plazhe e marina	**MTM**	**2019-2022**	5,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	5,000.00	Është një nga standardet ndërkombëtare të plazheve, të cilin kemi menduar ta fusim si koncept dhe ta zhvillojmë në plazhet tona.
			Përmirësimi i sistemit të sigurisë në det (roja bregdetare, shërbimet e shpëtimit)	**MTM**	**2019-2023**	15,000.00	10,000.00	1,400.00	2,600.00	2,600.00		0.00	5,000.00	Nga sezoni veror u evidentua nevoja për shtimin e kullave të vrojtimit me pajisjet përkatëse dhe të rojeve bregdetare të trajnuar.
			Bashkëpunim për zhvillimin e produktit dhe infrastrukturës turistike në brendësi të territorit për lidhjen e saj me bregdetin	**MTM**	**2019-2023**	700.00	500.00	70.00	130.00	130.00		0.00	200.00	Për të rritur llojshmërinë e produkteve në këto zona.
3.2		**Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi i produkteve të reja**	Ndërtimi i tre shtigjeve rajonale dhe dy shtigjeve kombëtare të çiklizmit	**MTM, AKZM, NJ.V.V**	**2019-2023**	6,000.00	1,500.00	210.00	390.00	390.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	4,500.00	Nevojitet evidentim në terren dhe punë inxhinjerike për hartëzimin e itinerareve.
			Identifikimi dhe zhvillimi i katër vendndodhjeve për zhvillimin e alpinizmit	**MTM**	**2019-2023**	2,000.00	2,000.00	280.00	520.00	520.00		0.00	0.00	
			Identifikimi dhe zhvillimi i tre itinerareve të lundrimit me trap	**MTM**	**2019-2023**	3,000.00	3,000.00	420.00	780.00	780.00		0.00	0.00	
			Identifikimi, shënjimi dhe dixhitalizimi i pesë shtigjeve të reja rajonale dhe dy shtigjeve	**MTM**	**2019-2023**	7,000.00	5,000.00	700.00	1,300.00	1,300.00		0.00	2,000.00	Nevojitet evidentim në terren dhe punë inxhinjerike për hartëzimin e itinerareve.

			ndërkufitare të ecjes										
			Sinjalistikë turistike në destinacionet e agroturizmit në 100 fshatrat	**MTM**	**2019-2020**	100,000.00	50,000.00	17,000.00	33,000.00	0.00		0.00	50,000.00	Nevojë e lartë për sinjalistikë në zonat e projektit "100 fshatra".
			Studim për identifikimin e vendndodhjeve të përshtatshme për zhvillimin e skive dhe sporteve të tjera dimërore	**MTM**	**2019**	10,000.00	3,000.00	3,000.00	0.00	0.00		0.00	7,000.00	Është një nga llojet e turizmit e zhvilluar në mënyrë sporadike dhe që do të kërkojë një ekspertizë të thelluar.
			Krijimi i strukturës menaxhuese dhe zbatimi i PKST Alpe	**MTM**	**2019-2020**	8,000.00	8,000.00	2,800.00	5,200.00	0.00		0.00	0.00	
			Aktivitete për promovimin e turizmit të aventurës	**MTM**	**2019**	1,000.00	1,000.00	1,000.00	0.00	0.00		0.00	0.00	
			Qendra moderne të vizitorëve me funksion informues, orientues dhe edukues në parqet kombëtare.	**MTM**	**2019-2023**	8,000.00	8,000.00	1,120.00	2,080.00	2,080.00		0.00	0.00	
			Plane menaxhimi të përmirësuara për zonat e mbrojtura dhe përcaktimi i modeleve të zhvillimit të turizmit.	**MTM**	**2019-2023**	400.00	400.00	56.00	104.00	104.00		0.00	0.00	
			Zona të identifikuara për zhvillimin e sporteve ujore si lundrimi me kajak, rafting, lundrimi me kanoe, lundrimi me trap etj.	**Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë+ MTM**	**2019-2020**	10,000.00	8,000.00	2,800.00	5,200.00	0.00		0.00	2,000.00	Nevojiten ekspertë të fushave përkatëse për evidentimin në terren, si dhe një ekspertizë për vlerësimin e zonave të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarive sportive.
			Plan masash për sigurinë e vizitorëve në zonat natyrore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.	**MTM, MSHMS**	**2019-2020**	300.00	300.00	100.00	200.00	0.00		0.00	0.00	
3.3		**Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik dhe krijimi i produkteve të reja**	Plan Veprimi për Zhvillimin e Turizmit Kulturor në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.	**MTM, MK,**	**2019-2020**	350.00	350.00	120.00	230.00	0.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
			Promovimi i veprimtarive kulturore kombëtare në funksion të turizmit.	**MTM, AKT**	**2019-2023**	100.00	100.00	14.00	26.00	26.00		0.00	0.00	
			Botimi dhe promovimi i kalendarit vjetor të veprimtarive kulturore.	**MTM, AKT, NJ.V.V**	**2019-2023**	1,000.00	1,000.00	140.00	260.00	260.00		0.00	0.00	
			Objekte karakteristike arkitekturore të rikonstruktuara dhe të kthyera në objekte kulturore e struktura akomoduese.	**MTM, MK**	**2019-2023**	300.00	300.00	42.00	78.00	78.00		0.00	0.00	
			Oferte turistike e diversifikuar përmes përkrahjes së skenës së pavarur kulturore.	**MK+MTM**	**2019-2023**	800.00	800.00	112.00	208.00	208.00		0.00	0.00	
			Zhvillimi i itinerareve historike e	**MTM, MK**	**2019-2023**	1,500.00	1,500.00	210.00	390.00	390.00		0.00	0.00	

			kulturore si Via Egnatia, Via Dinarica, Rruga e Verës dhe Ullirit, Rruga e Perandorëve Romakë, Rruga e "Yjeve të Kuq", Rruga e Besimit, Rruga e Kujtesës.											
			Infrastrukturë rrugore dhe sinjalistike e përmirësuar drejt destinacioneve arkeologjike.	**MK+MTM**	**2019-2023**	500.00	500.00	70.00	130.00	130.00		0.00	0.00	
			Promovimi i turizmit kulinar duke krijuar një rrjet pikash lokale të ndërlidhura.	**MTM, AKT**	**2019-2020**	14,000.00	8,000.00	2,800.00	5,200.00	0.00		0.00	6,000.00	Është një pikë e fortë për marketimin e turizmit shqiptar.
			Plan Veprimi për Zhvillimin e Turizmit Shëndetësor në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.	**MTM, MSHMS**	**2019-2022**	8,000.00	8,000.00	130.00	250.00	250.00		0.00	0.00	
			Hartimi i një studimi mbi mundësinë e zhvillimit të turizmit shëndetësor në vendburimet kryesore termale.	**MTM**	**2019**	5,000.00	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00		0.00	0.00	
			Destinacione shqiptare të turizmit shëndetësor të lidhura me rrjetet e njohura ndërkombëtare.	**MTM, AKT**	**2019-2023**	4,000.00	4,000.00	560.00	1,040.00	1,040.00		0.00	0.00	
			Krijimi i një shoqate kombëtare të operatorëve të turizmit shëndetësor.	**MTM, MSHMS**	**2020**	500.00	500.00	0.00	500.00	0.00		0.00	0.00	
			Studim mbi mundësinë e zhvillimit të turizmit të biznesit e konferencave.	**MTM**	**2019-2020**	7,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00	7,000.00	Është një formë e re e turizmit e cila po zhvillohet në mënyrë të paplanifikuar.
4						**704,200.00**	**452,006.00**	**43,103.60**	**88,032.40**	**142,442.40**		**221,473.60**	**30,720.40**	
4.1		**Hartimi i Planit të Brandit dhe Marketingut të Turizmit**	Plani Kombëtar për Brandin dhe Marketimin e Turizmit.	**MTM, AKT**	**2021**	20,000.00	20,000.00	0.00	0.00	20,000.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
4.2	**Riorientim i Promovimit drejt Potencialeve**	**Promovimi i Produkteve Turistike gjithëvjetore brenda dhe jashtë vendit**	Zgjatjen e sezonit turistik përmes orientimit të veprimtarive promovuese drejt tregjeve të reja.	**MTM, AKT**	**2019-2023**	500.00	500.00	70.00	130.00	130.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
			Studim mbi mundësinë e hapjes së zyrave të turizmit pranë përfaqësive diplomatike shqiptare.	**MEPJ, MTM, AKT**	**2019-2023**	500.00	500.00	70.00	130.00	130.00		0.00	0.00	
			Pjesëmarrja në ekspozita e panaire ndërkombëtare për turizmin.	**AKT**	**2019-2023**	229,500.00	224,500.00	14,870.00	45,530.00	63,400.00		0.00	5,000.00	Për një promocion më agresiv të turizmit shqiptar.
			Promocioni jashtë vendit nëpërmjet bashkëpunimit me përfaqësitë tona diplomatike.	**MTM, AKT, MEPJ**	**2019-2023**	500.00	500.00	100.00	100.00	100.00		0.00	0.00	
			Ndryshimi i regjimit të vizave	**MTM, AKT,**	**2019-2023**	500.00	500.00	100.00	100.00	100.00		0.00	0.00	

			për shtetasit nga vendet tregje të synuara.	**MEPJ, MB**										
			Kalendari vjetor mbi turizmin.	**AKT**	**2019-2023**	7,000.00	7,000.00	980.00	1,820.00	1,820.00		0.00	0.00	
			Spote dhe materiale promocionale për turizmin.	**AKT**	**2019-2023**	199,500.00	179,500.00	20,100.00	31,700.00	56,700.00		0.00	20,000.00	Për më shumëllojshmëri materialesh dhe për një promocion më agresiv të turizmit shqiptar.
			Përfshirja e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të kulinarisë.	**AKT**	**2019-2020**	8,000.00	5,000.00	1,700.00	3,300.00	0.00		0.00	3,000.00	Është një pikë e fortë për marketimin e turizmit shqiptar.
			Përfshirja e Shqipërisë në guidat ndërkombëtare të ecjes dhe çiklizmit.	**AKT**	**2020**	7,000.00	5,000.00	0.00	5,000.00	0.00		0.00	2,000.00	Bashkëpunim me shoqatat ndërkombëtare të këtyre sporteve për përfshirjen dhe promovimin e itinerareve shqiptare në gudat e tyre.
			Innotourclust - IPA	**AKT**	**2019 - 2021**	95,000.00	1,904.00	0.00	0.00	0.00		93,096.00	0.00	
			THEMA - IPA	**AKT**	**2019 - 2021**	47,000.00	842.00	0.00	0.00	0.00		46,157.60	0.40	
			TREC - Agencia Italiana per Colaborazione e Sviluppo	**AKT**	**2020 - 2021**	83,000.00	780.00	0.00	0.00	0.00		82,220.00	0.00	
4.3		**Mbështetja e Agjentëve Promovues të vendit në Shqipëri dhe Diasporë**	Portali shqiptar i turizmit "e-turizëm" i lidhur me aplikacione që ofrojnë informacion mbi destinacionet e atraksionet.	**MTM, AKT, AKSHI**	**2019-2020**	700.00	240.00	80.00	160.00	0.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"; Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrimi" i MTM-së	0.00	460.00	Nevoja për mirëmbajtje dhe pasurim me të dhëna të reja.
			Ngritja në të gjithë vendin e pikave të informimit turistik sipas rregullores së miratuar.	**AKT**	**2019-2023**	500.00	240.00	33.60	62.40	62.40		0.00	260.00	Mbështetje duke konsideruar rëndësinë e krijimit të zyrave të informacionit turistik.
			Ngritja dhe publikimi i regjistrit elektronik të atraksioneve dhe produkteve turistike.	**MTM**	**2019**	5,000.00	5,000.00	5,000.00	0.00	0.00		0.00	0.00	
5						**108,640.00**	**108,640.00**	**27,154.00**	**61,026.00**	**8,856.00**		**0.00**	**0.00**	
5.1	**Mbështetje për Menaxhimin e Destinacioneve**	**Zhvillimi i modelit të Menaxhimit të Destinacioneve**	Studim për të ngritjen e Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit	**MTM**	**2019-2020**	5,000.00	5,000.00	1,700.00	3,300.00	0.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"	0.00	0.00	
			Krijimi i Modelit të DMO-ve në zona pilot me potencial të lartë zhvillimi	**MTM, NJ.V.V**	**2020-2023**	20,000.00	20,000.00	0.00	6,000.00	6,000.00		0.00	0.00	
			Krijimi i qendrave të vizitueshme në destinacionet kryesore	**MIE, MTM**	**2019-2023**	5,000.00	5,000.00	700.00	1,300.00	1,300.00		0.00	0.00	
			Identifikimi i mundësive për zhvillimin e veprimtarive të reja në destinacionet ekzistuese	**MTM, NJ.V.V**	**2019-2020**	1,500.00	1,500.00	500.00	1,000.00	0.00		0.00	0.00	
			Rritja e cilësisë dhe e llojeve të shërbimeve në destinacionet turistike.	**MTM, NJ.V.V, AKU**	**2019-2021**	240.00	240.00	40.00	100.00	100.00		0.00	0.00	
5.2		**Konsolidimi i kuadrit ligjor**	Plane të detajuara për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.	**MTM**	**2019-2023**	100.00	100.00	14.00	26.00	26.00	Programi "Zhvillimi i	0.00	0.00	

		dhe institucional për menaxhimin dhe operimin e Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve	Kuadër ligjor për destinacionet, i përditësuar.	**MTM**	**2019-2023**	500.00	500.00	70.00	130.00	130.00	Turizmit"; Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrimi" i MTM-së	0.00	0.00	
			Ngritja dhe funksionimi i degëve territoriale të turizmit.	**MTM**	**2019-2020**	300.00	300.00	100.00	200.00	0.00		0.00	0.00	
5.3		**Monitorimi dhe Mbështetja e Organizatave të Menaxhimit të Destinacioneve**	Studim mbi metodologjinë ekzistuese të mbledhjes së të dhënave statistikore dhe identifikimi i problematikave	**MTM, INSTAT, MB, BoA**	**2019-2020**	1,000.00	1,000.00	330.00	670.00	0.00	Programi "Zhvillimi i Turizmit"; Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrimi" i MTM-së	0.00	0.00	
			Zhvillimi i sistemit të monitorimit të indikatorëve të turizmit në nivel destinacioni	**MTM**	**2019-2020**	70,000.00	70,000.00	23,000.00	47,000.00	0.00		0.00	0.00	
			Publikimi periodik i statistikave për turizmin në funksion të hartimit të politikave dhe orientimit të investimeve private	**MTM, INSTAT, BoA**	**2019-2023**	5,000.00	5,000.00	700.00	1,300.00	1,300.00		0.00	0.00	
TOTALI						**1,829,840.00**	**1,424,146.00**	**198,746.00**	**372,700.00**	**372,700.00**		**221,473.60**	**184,220.40**	

Lista e indikatorëve/treguesve të dokumenteve strategjike

Shënim. 1. Për secilin indikator të përbërë nga nënindikatorë të përdoret një fletë pune (*sheet*).

2. Në rastin e indikatorëve të thjeshtë mund të plotësohen në të njëjtën fletë pune, në rreshta të veçanta

		INDIKATORI 1	INDIKATORI 2	INDIKATORI 3	INDIKATORI 4	INDIKATORI 5
1	**Emërtimi i indikatorit**	Kontributi direkt i sektorit të turizmit në PBB	Kontributi direkt në nivelin e punësimit i sektorit të Turizmit	Rritja e investimeve në sektorin e turizmit në raport me investimet publike	Rritja e numrit të vizitorëve të huaj (turizmi në hyrje)	Rritja e netqëndrimeve në të gjithë llojet e strukturave akomoduese
2	**Lloji i indikatorit**	Nivel i lartë	Nivel I lartë	Nivel I lartë	Nivel I lartë	Nivel I lartë
3	**Nr…Datë…., Emërtimi i dokumentit**	Draft Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023; SKZHI	Draft Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023; SKZHI	Draft Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023; SKZHI	Draft Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023; SKZHI	Draft Strategjia për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023; SKZHI
4	**Lidhja me SKZHI (nr. i shtyllës)**	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit	6. Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zhvillimit të territorit
5	**Qëllimi/Objektivi strategjik në SKZHI**					
6	**Qëllimi i politikës korresponduese**					
7	**Objektivi specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi**			Nxitja e Investimeve Publike dhe Private	Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim	Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim
8	**Përkatësia e indikatorit**	Sektor	Sektor	Sektor	Sektor	Sektor
9	**Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës**	Burime të huaja: Raporti i Impaktit Ekonomik të Udhëtimeve dhe Turizmit i Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (ëTTC);	Burime të huaja: Raporti i Impaktit Ekonomik të Udhëtimeve dhe Turizmit i Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (ëTTC);	INSTAT	Ministria e Brendshme	Banka e Shqipërisë
10	**Institucionet përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave.**			INSTAT	Ministria e Brendshme	Banka e Shqipërisë
11				Njësitë e Qeverisjes Vendore, AZHT		
12	**Përshkrimi i metodologjisë**				Regjistrimi I hyrjeve të shtetasve të huaj në sistemin TIMS të Ministrisë së Brendshme	
13	**Frekuenca e matjes**	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore
14		Vjetore	Vjetore	3 Mujore	Mujore	3-Mujore
15	**Natyra e indikatorit/treguesit: Kumulativ/ritës**	Kumulativ	Kumulativ	Ritës (%)	Kumulativ	Kumulativ
16	**Input direkt ose i përbërë**	I përbërë	I përbërë	I përbërë	I përbërë	I përbërë
17	**Formula e llogaritjes**			% rritjes= (Vlera e vitit paraardhës -vlerën e vitit aktual)/vlerën e vitit parardhësX100	% rritjes= (Vlera e vitit paraardhës -vlerën e vitit aktual)/vlerën e vitit parardhësX101	% rritjes= (Vlera e vitit paraardhës -vlerën e vitit aktual)/vlerën e vitit parardhësX102
18	**Ndarja e të dhënave (për treguesit e përbërë)**					
19						
20						
21	**Theksoni drejtimin e ndryshimit / trendit (tendencës) të ecurisë**	Ritëse	Ritëse	Ritëse	Ritëse	Ritëse
22	**Vlerat bazë**	2018	2018	2018	2018	2018
23		8.70%	7.80%	5.90%	5,927,000	26,541,551
24	**Vlera e synuar/ targeti**	Viti 2019, vlera e synuar 9.0%	Viti 2019, vlera e synuar 8.0%	6%	6,401,160	27,868,629
25		Viti 2020, trend ritës	Viti 2020, trend ritës	6.10%	6,913,253	29,262,060
26		Viti 2021, trend ritës	Viti 2021, trend ritës	6.20%	mbi 7 milionë	mbi 30 milionë
27	**Vlera e synuar/targeti i rishikuar:**					
28	**Vlera aktuale:**					
29	**SDG - Titulli i qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm sipas OKB-së**	SDG 8:Promote inclusive and sustainable economic growth, employment and decent work for all	SDG 8:Promote inclusive and sustainable economic growth, employment and decent work for all	SDG 8:Promote inclusive and sustainable economic growth, employment and decent work for all	SDG 8 Promote inclusive and sustainable economic growth, employment and decent work for all. SDG 11 Make cities and human settlements inclusive, safe, resilient and sustainable	SDG 8 Promote inclusive and sustainable economic growth, employment and decent work for all. SDG 11 Make cities and human settlements inclusive, safe, resilient and sustainable
30	**Vlera e Synuar e treguesit të SDG**					

URDHËR
Nr. 156, datë 21.6.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004 "Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", neni 26 i Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015 "Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Financës Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, znj. Klarita Bejko.

2. Znj. Klarita Bejko ngarkohet me:

- ndjekjen dhe zbatimin e "Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar" (i ndryshuar);
- ndjekjen e detyrave të vendosura në planin mujor të muajit qershor 2019;
- merr dhe trajton korrespondencën shkresore urgjente;
- ndjekjen e detyrave të grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore.

3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjësit të Sektorit për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit z. Adhurim Hasanaj;

4. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat si më poshtë:

a) mbikëqyr dhe udhëzon Grupin e Punës për Kontrollin e Figurës së subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;

b) përfaqëson Grupin e Punës në marrëdhëniet me:

- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);
- Kolegjin e Apelimit (KA) dhe Komisionerët Publikë;
- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM);

c) organizon dhe drejton veprimtarinë e Grupit të Punës.

ç) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur Grupi i Punës;

d) merr dhe trajton korrespondencën shkresore që lidhet me veprimtarinë e Grupit të Punës.

5. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën 24.6.2019 deri më 27.6.2019.

6. Znj. Klarita Bejko dhe z. Hasanaj nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

7. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Financës Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 644 lekë